# FLETORJA ZYRTARE
# E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË


**Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare**

**www.legjislacioni.gov.al**

**Nr.92 Datë 19 qershor 2014**


P Ë R M B A J T J A


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr. 360, datë 11.6.2014 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 419, datë 15.5.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë" ........................................................ | 3653 |
| Vendim i KM nr. 365, datë 11.6.2014 | Për miratimin e raportit vjetor "Për ndihmat shtetërore të vitit 2013"........................................................................... | 3653 |
| Vendim i KM nr. 366, datë 11.6.2014 | Për heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor të sipërfaqeve pyjore e kullosore që do të përdoren nga shoqëria TAP-AG për ndërtimin e rrjetit rrugor............................................................ | 3659 |
| Vendim i KM nr. 367, datë 11.6.2014 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1701, datë 17.12.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë, që nuk janë objekt koncesioni"...................................................... | 3662 |
| Vendim i KM nr. 371, datë 11.6.2014 | Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre.................. | 3662 |
| Vendim i KM nr. 372, datë 11.6.2014 | Për shfuqizimin e vendimit nr. 8, datë 5.1.2002, të Këshillit të Ministrave,"Për krijimin e Komitetit Shtetëror të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore", të ndryshuar....................... | 3667 |
| Vendim i KM nr. 373, datë 11.6.2014 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, kultura bujqësore dhe dru frutorë, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza Lindore Shkodër"................................................................. | 3667 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr. 374, datë 11.6.2014 | Për miratimin e mënyrës së përdorimit të fondeve kundërparti, të mbledhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë………. | 3670 |
| Vendim i KM nr. 375, datë 11.6.2014 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 904, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike në zonat pilot"……………………………… | 3670 |
| Vendim i KM nr. 376, datë 11.6.2014 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 787, datë 14.12.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike", të ndryshuar……………………………………………………… | 3676 |
| Vendim i KM nr. 377, datë 11.6.2014 | Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Shërbimit Kombëtar për Rininë………………………………… | 3679 |
| Vendim i KM nr. 379, datë 11.6.2014 | Për disa shtesa në vendimin nr. 1, datë 10.1.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për prokurimin publik", të ndryshuar……………………………………………………… | 3680 |
| Vendim i KM nr. 380, datë 11.6.2014 | Për disa shtesa në vendimin nr. 942, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave,"Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura"………………………………………………………… | 3681 |
| | Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Abdyl Mustafa Koka… | 3681 |

**VENDIM**
**Nr. 360, datë 11.6.2014**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 419, DATË 15.5.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË KONKURRUESHMËRISË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, 6, shkronjat "a", "b", "d", "e", dhe 7, pika 1, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla e të mesme", të ndryshuar, dhe të neneve 17 e 18 të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 419, datë 15.5.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë u jep ndihmë financiare të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, deri në 1 400 000 (një milion e katërqind mijë) lekë, por në asnjë rast më shumë se 70% të kostove të pranueshme. Në kostot e pranueshme që mund të bashkëfinancohen, përfshihen kostot për:

a) përshtatje produkti, përfshirë ambalazhimin dhe etiketimin, certifikim produkti, vlerësim konformiteti dhe zbatim të sistemeve të menaxhimit të cilësisë;

b) pjesëmarrje në panaire jashtë vendit;

c) krijim faqeje interneti, zhvillim të tregtisë elektronike dhe promovim, publikim dhe hartim materialesh promovuese;

ç) shërbime këshillimore. Në këtë rast kostot që mund të bashkëfinancohen nuk mund të jenë më shumë se 50 % e kostos totale të këtyre shërbimeve.".

2. Në shkronjën "a" të pikës 3 hiqen fjalët "… dhe që gjatë procesit i japin një vlerë të shtuar të konsiderueshme produktit përfundimtar …".

3. Në shkronjën "b" të pikës 3 hiqen fjalët "… për zgjerimin e eksporteve …".

4. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë të zbatohet për një periudhë 3-vjeçare, gjatë viteve 2013 dhe 2014, me një vlerë prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh për secilin vit, ndërsa për vitin 2015, me një vlerë prej 28 000 000 (njëzet e tetë milionë) lekësh.".

5. Kudo në vendim emërtimi "Ministri/a i/e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës" zëvendësohet me "Ministri/a përgjegjës/e për ekonominë".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 365, datë 11.6.2014**

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR "PËR NDIHMAT SHTETËRORE TË VITIT 2013"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, shkronja "dh", 18, shkronja "e", dhe 32, pika 2, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit vjetor "Për ndihmat shtetërore të vitit 2013", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**RAPORTI**
PËR NDIHMAT SHTETËRORE 2013

1. HYRJE

Raporti vjetor mbi ndihmën shtetërore për vitin 2013 përmban një përshkrim analitik të ndihmës shtetërore në Republikën e Shqipërisë në vitin 2013 të shoqëruar më të dhënat e përditësuara të ndihmës shtetërore të vitit 2011 dhe 2012. Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, dhënësit e ndihmës detyrohen që brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesin pranë Drejtorisë së Tregut të Brendshëm, raportin e zbatimit për të gjitha skemat e ndihmës shtetërore dhe ndihmat individuale të dhëna gjatë vitit paraardhës financiar. Mbi bazën e tyre përgatitet Raporti Vjetor i Ndihmave Shtetërore, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Të dhënat e përfshira në këtë raport janë raportuar nga dhënës të ndihmës shtetërore, si: Ministria e Financave (MF), Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS), Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve), Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (Shërbimi Kombëtar i Punësimit), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

Në hartimin e raportit të shtatëvjetor për ndihmat shtetërore, struktura e raportimit të ndihmës shtetërore është bazuar në aneksin III të rregullores "Për procedurat dhe formën e njoftimit" [1], si dhe në metodologjinë e

[1] VKM nr. 817, datë 28.12.2005: "Për miratimin e rregullores për procedurat dhe formën e njoftimit".

Komisionit Evropian[2]. Në këtë mënyrë në raport jepet një krahasim i shumës së ndihmës dhe informacion për strukturën e ndihmës shtetërore në BE dhe shtetet anëtare.

Në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Europian, neni 71, pika 5, parashikohet se vendi ynë duhet të garantojë transparencë në fushën e ndihmës shtetërore, duke paraqitur raportin vjetor dhe duke ndjekur metodologjinë e Komunitetit për ndihmën shtetërore. Për këtë arsye, ligji nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, ngarkon strukturat e ndihmës shtetërore[3] për përgatitjen e këtij raporti, duke plotësuar një detyrim ligjor dhe duke shënuar një hap përpara në drejtim të angazhimeve që ka ndërmarrë vendi ynë në fushën e ndihmës shtetërore në kuadër të procesit të integrimit.

Sipas metodologjisë, ndihma shtetërore klasifikohet në dy grupe kryesore:

1. Ndihma shtetërore për bujqësinë dhe peshkimin; dhe

2. Ndihma shtetërore për industrinë dhe shërbimet.

Ndihma shtetërore për industrinë dhe shërbimet përfshin kategorinë e ndihmës horizontale dhe ndihmës sektoriale.

Ndihma shtetërore horizontale përfshin:

- Ndihmën për kërkim-zhvillim dhe inovacion;
- Ndihmën për mbrojtjen e mjedisit;
- Ndihmën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
- Ndihmën për punësim;
- Ndihmën për trajnim;
- Ndihmën operacionale.

Ndihma shtetërore sektoriale përfshin:

- Ndihmën për transportin publik;
- Ndihmën për shërbimet publike;
- Ndihmën për minierat;
- Ndihmën për energjinë.

Ndihma shtetërore mund të jepet duke përdorur disa instrumente të ndihmës, si:

A1 - Subvencione dhe grante;

A2- Përjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale;

B - Pjesëmarrja në kapital;

C1 - Hua të buta;

C2 - Instrumente të tjera;

D – Garancitë.

## 2. NDIHMAT SHTETËRORE NË SHQIPËRI NË VITIN 2013

### 2.1 Ndihma shtetërore në Shqipëri krahasuar me treguesit kryesorë makroekonomikë

Tabela nr. 1: Ndihma shtetërore krahasuar me disa nga treguesit makro

Burimi: MF, INSTAT dhe MZHETS

| Treguesit | Njësia e matjes | 2011 | 2012 | 2013 |
|---|---|---|---|---|
| Ndihma Shtetërore | mln euro | 117,52 | 154,56 | 143,85 |
| PBB | mln euro | 9.125,07 | 9.540,94 | 9.681,00 |
| Ndihma Shtetërore/PBB | % | 1,29 | 1,62 | 1,49 |
| Shpenzimet nga buxheti i shtetit | mln euro | 2,679 | 2.707 | 2,919 |
| Ndihma shtetërore/Shpenzimet buxheti i shtetit | % | 4,4 | 5,7 | 4,96 |
| Të punësuar | mijë | 1.161 | 1.117 | 928 |
| Ndihma shtetërore per çdo të punësuar | euro | 101 | 138 | 156 |
| Popullsia | milion | 2,84 | 2,82 | 2,79 |
| Ndihma Shtetërore për frymë | euro | 41 | 55 | 52 |

Tabela nr. 1 paraqet të dhënat për ndihmën shtetërore gjithsej të dhënë në Shqipëri në tre vitet e fundit (2011, 2012 dhe 2013) të krahasuara me disa nga treguesit bazë makroekonomikë. Ndihma shtetërore në vlerë absolute e dhënë në vitin 2013 është 7% më pak në krahasim me vitin 2012, dhe 22% më i lartë në krahasim me ndihmën shtetërore në vitin 2011. Përqindja e raportit të ndihmës shtetërore ndaj PBB-së zbriti nga 1.62% në 2012 në 1.49% në vitin 2013.

Ndihma shtetërore përfshirë sektorin e bujqësisë dhe peshkimit në vitin 2013 është dhënë në vlerën totale prej 20.178,13 mln lekë (143,85 mln euro).

Ndihma shtetërore, përjashtuar sektorin e bujqësisë dhe peshkimit në vitin 2013 është dhënë në vlerën totale prej 19.021,23 mln lekë (135, 6 mln euro).

Raporti vjetor përmban të dhëna për vitin 2011, 2012 dhe 2013, por në grafikun nr. 1 tregohet ecuria e ndihmës shtetërore në Shqipëri nga viti 2005 e në vazhdim, periudhë për të cilën janë raportuar të dhënat e ndihmës shtetërore.

Grafiku nr. 1: Ndihma shtetërore në raport ndaj PBB për periudhën 2005 – 2013




[2] Ligji nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar

[3] Neni 17 "Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit", shkronja f), dhe neni 18, shkronja g) "përgatit Raportin Vjetor".

2.2 Ndihma shtetërore në Shqipëri e krahasuar me shtetet anëtare të BE-së

Tabela nr. 2: Ndihma shtetërore 2011-2012

Burimi: Komisioni Evropian, DG Competition[4] dhe MZHETS

| Ndihma shtetërore, përjashtuar ndihmën për sektorin e hekurudhave | 2011 | 2012 | 2011 | 2012 |
|---|---|---|---|---|
| | në % ndaj PBB | | në mln euro | |
| Shqipëria | 1,25 | 1,58 | 114,52 | 151,39 |
| EU (27 shtete) | 0,51 | 0,52 | 65.793,30 | 67.158,00 |
| Belgium | 0,43 | 0,39 | 1.621,30 | 1.466,50 |
| Bulgaria | 0,11 | 0,19 | 43,10 | 77,10 |
| Czech Republic | 0,91 | 1,01 | 1.408,80 | 1.532,40 |
| Denmark | 0,97 | 1,07 | 2.388,60 | 2.603,70 |
| Germany | 0,46 | 0,45 | 12.110,20 | 11.872,00 |
| Estonia | 0,30 | 0,34 | 48,90 | 58,30 |
| Ireland | 0,65 | 0,53 | 1.048,30 | 873,30 |
| Greece | 1,24 | 0,99 | 2.566,80 | 1.917,00 |
| Spain | 0,42 | 0,38 | 4.508,10 | 3.944,00 |
| France | 0,66 | 0,74 | 13.347,00 | 14.983,30 |
| Italy | 0,24 | 0,37 | 3.764,20 | 5.731,60 |
| Cyprus | 0,78 | 0,66 | 143,60 | 118,30 |
| Latvia | 0,89 | 1,57 | 187,60 | 348,20 |
| Lithuania | 0,69 | 0,71 | 217,30 | 233,00 |
| Luxembourg | 0,25 | 0,22 | 111,10 | 96,20 |
| Hungary | 1,20 | 1,10 | 1.188,90 | 1.074,80 |
| Malta | 1,47 | 1,54 | 98,80 | 103,90 |
| Netherlands | 0,45 | 0,40 | 2.724,60 | 2.402,10 |
| Austria | 0,56 | 0,60 | 1.727,30 | 1.851,40 |
| Poland | 0,78 | 0,72 | 2.909,00 | 2.745,70 |
| Portugal | 0,97 | 0,56 | 1.655,90 | 920,60 |
| Romania | 0,49 | 0,63 | 635,20 | 828,20 |
| Slovenia | 1,10 | 1,27 | 397,90 | 449,30 |
| Slovakia | 0,25 | 0,18 | 173,00 | 130,70 |
| Finland | 1,54 | 1,36 | 2.998,50 | 2.652,20 |
| Sweden | 0,79 | 0,79 | 3.206,10 | 3.228,40 |
| United Kingdom | 0,24 | 0,26 | 4.563,00 | 4.915,90 |

Tabela nr. 2 paraqet informacion për ndihmën shtetërore në Shqipëri dhe 27 shtetet e Bashkimit Evropian për vitin 2011 dhe 2012. Në tabelë janë përfshirë të dhënat e publikuara nga Komisioni Evropian në vitin 2013 për ndihmën shtetërore, duke përjashtuar ndihmën që japin shtetet anëtare për përballimin e krizës ekonomike.

Ndihma përfshin shpenzimet që ka kryer çdo shtet anëtar, e cila është orientuar për realizimin e objektivave horizontale me interes të përbashkët, ndihmën e dhënë për sektorët të ndryshëm të ekonomisë, si p.sh. bujqësia, peshkimi, transporti, si edhe ndihmën për arritjen e objektivave të veçantë, si p.sh. shpëtim dhe ristrukturim, ndihmën për mbylljen e ndërmarrjeve, duke përjashtuar ndihmën për sektorin e hekurudhave.

Duke krahasuar të dhënat e shteteve anëtare dhe Shqipërisë, përqindja e pjesës së ndihmës shtetërore ndaj PBB-së (duke përjashtuar sektorin e transportit) arrin në 1.58 % në vitin 2012.

2.3 Kategoritë e ndihmës shtetërore

Sipas metodologjisë së Bashkimit Evropian, ndihma shtetërore ndahet në këto kategori:

- Ndihmë shtetërore horizontale; dhe
- Ndihmë shtetërore sektoriale.

Ndihma shtetërore horizontale jepet për një numër të madh përfituesish, pa dhënë preferenca për ndonjë aktivitet ekonomik, ndërmarrje ekonomike, produkt apo shërbim, duke minimizuar efektet në konkurrencë.

Ndihma shtetërore sektoriale jepet për aktivitete dhe sektorë të veçantë, duke patur një ndikim më të madh në konkurrencën në treg.

Tabela nr. 3: Ndihma shtetërore gjithsej 2011- 2013 ndarë sipas kategorive (përfshirë bujqësinë dhe peshkimin-vlerat në mln lekë)

Burimi: Drejtoria e Tregut të Brendshëm, MZHETS

| KATEGORIA | 2011 | | 2012 | | 2013 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | mln lekë | në % | mln lekë | në % | mln lekë | në % |
| **Bujqësia** | 2.167,58 | 13,10 | 2.163,85 | 10,07 | 1.156,90 | 5,73 |
| **Ndihma Horizontale** | 11.982,85 | 72,42 | 16.805,53 | 78,24 | 17.881,62 | 88,62 |
| *Punësimi* | 37,25 | 0,23 | 23,30 | 0,11 | 21,10 | 0,10 |
| *Trajnim* | 62,30 | 0,38 | 64,80 | 0,30 | 63,10 | 0,31 |
| *Mjedisi* | - | - | - | - | - | - |
| *Eksporti* | - | - | - | - | - | - |
| *Ndihma operacionale* | 2.483,52 | 15,01 | 2.205,33 | 10,27 | 1.160,12 | 5,75 |
| *Shpetim dhe ristrukturim* | - | - | - | - | - | - |
| *Kerkim, zhvillim dhe inovacion* | 9.399,78 | 56,81 | 14.504,00 | 67,52 | 16.629,32 | 82,41 |
| *SME* | - | - | 8,10 | 0,04 | 7,98 | |
| *të tjera* | - | - | - | - | - | - |
| **Ndihma Sektoriale** | 2.394,86 | 14,47 | 2.511,39 | 11,69 | 1.139,61 | 5,65 |
| *Transport publik (Hekurudha)* | 452,00 | 2,73 | 440,00 | 2,05 | 440,00 | 2,18 |
| *Shërbimi publik* | 773,00 | 4,67 | 787,00 | 3,66 | 600,00 | 2,97 |
| *Minierat* | 5,00 | 0,03 | 13,00 | 0,06 | 13,90 | 0,07 |
| *Energjia* | 1.161,97 | 7,02 | 1.268,50 | 5,91 | 85,71 | 0,42 |
| *Turizmi* | - | - | - | - | - | - |
| *të tjera* | 2,89 | 0,02 | 2,89 | 0,01 | - | - |
| **TOTALI** | **16.545,29** | **100** | **21.480,77** | **100** | **20.178,13** | **100** |

[4] http://ec.europa.eu/competition/state_aid/scoreboard/index_en.html

Grafiku nr. 2: Ndihma shtetërore sipas kategorive




Të dhënat në tabelën 3 dhe të paraqitura në grafikun 2, tregojnë se në vitin 2013 ndihma horizontale përbën pjesën më të madhe të ndihmës shtetërore gjithsej me 88.03 %, ndërsa kategoria e ndihmave sektoriale përbën 6.27 %.

2.3.1. Ndihma shtetërore horizontale

Në vitin 2013 ndihma shtetërore horizontale në vlerë absolute është 17.881,57 mln lekë (127,48 mln euro) dhe e krahasuar me vitin 2012 është rritur me 6.4 %. Pesha për këtë kategori në totalin e ndihmës në vitin 2013 është rritur me 10 % krahasuar me vitin 2012.

Tabela nr. 4: Ndihma shtetërore horizontale 2011-2013(mln lekë/mln euro)

Burimi: Drejtoria e Tregut të Brendshëm, MZHETS

| Ndihma Horizontale | 2011 | | 2012 | | 2013 | | ndryshimi 2012/2011 | ndryshimi 2013/2012 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | mln LEK | mln EUR | mln LEK | mln EUR | mln LEK | mln EUR | | |
| kursi mes. i këmbimit | | 140,33 | | 139,04 | | 140,27 | | |
| Punësimi | 37,25 | 0,27 | 23,30 | 0,17 | 21,07 | 0,15 | 62,55 | 90,41 |
| Kultura | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Mjedisi | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Eksporti | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Ndihma operacionale | 2.483,52 | 17,70 | 2.205,33 | 15,86 | 1.160,10 | 8,27 | 88,80 | 52,60 |
| Shpëtim dhe Ristrukturim | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Kërkim dhe Zhvillim | 9.399,78 | 66,98 | 14.504,00 | 104,32 | 16.629,32 | 118,55 | 154,30 | 114,65 |
| SME-të | - | - | 8,10 | 0,06 | 7,98 | 0,06 | - | 98,52 |
| Sporti | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Trajnimi | 62,30 | 0,44 | 64,80 | 0,47 | 63,10 | 0,45 | 104,01 | 97,38 |
| **Total** | **11.982,85** | **85,39** | **16.805,53** | **120,87** | **17.881,57** | **127,48** | **140,25** | **106,40** |

Grafiku nr. 4: Ecuria e ndihmës shtetërore horizontale (mln euro)




Sipas të dhënave në tabelën 4, ndihma shtetërore horizontale në vitin 2013 është rritur me 6.4 % e krahasuar me vitin 2012, dhe me 40 % e krahasuar me vitin 2011.

Grafiku nr. 5: Struktura e ndihmës shtetërore horizontale në vitet 2011-2013




Ndihma për kërkim dhe zhvillim. Edhe në vitin 2013 vazhdon të zërë pjesën më të rëndësishme në kategorinë e ndihmës horizontale. Sipas raportimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, ndihmë shtetërore për kërkim dhe zhvillim kanë përfituar ndërmarrjet që nënshkruajnë "marrëveshje hidrokarburesh" [5] dhe nënkontraktuesit e tyre, duke iu ofruar një përjashtim nga detyrimet doganore për pajisjet, makineritë, materialet, si dhe një përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar të të gjithë kontraktorëve dhe nënkontraktorëve për realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure.

5 Sipas ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet", "Marrëveshje hidrokarburesh" do të thotë një marrëveshje e lidhur nga Ministria në përputhje me paragrafin 1 të nenit 5 të këtij ligji, që autorizon Kontraktorin të kryejë operacione në Zonën e Kontratës dhe mund të marrë formën e një Marrëveshjeje me Ndarje Prodhimi ose ndonjë formë tjetër të rënë dakord mes Ministrisë dhe Kontraktorit e cila nuk është në kundërshtim me këtë ligj."

Ndihma operacionale. Kjo kategori përfshin skemën e shtyrjes së TVSH-së për importin e makinerive dhe pajisjeve[6], skemën e rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse për prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet me fuqi më të madhe se 5 MW[7], skemën e rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serat me ngrohje[8]. Për vitin 2013 në këtë kategori janë raportuar të dhëna për ndërmarrjet, të cilat kanë përfituar nga zbatimi i skemës së shtyrjes së TVSH-së për importin e makinerive dhe pajisjeve në vlerën 1,138 miliard lekë dhe përfitimi i ndërmarrjeve nga skema e rimbursimi të akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serat me ngrohje në vlerën 22 mln lekë.

Ndihma për trajnim. Mbështetur në raportimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP) nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë nëpërmjet formimit në punë [9], kanë përfituar 28 ndërmarrje SME me veprimtari ekonomike në fushën e konfeksioneve, duke u krijuar 436 vende të reja të punës.

Ndihma për punësim. Sipas të dhënave të SHKP, nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë në vështirësi[10], kanë përfituar 8 ndërmarrje SME me veprimtari ekonomike në fushën e prodhimit të këpucëve, ndërtim dhe peshkim, duke u krijuar 282 vende të reja të punës. Nga programi i nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta[11], kanë përfituar 4 ndërmarrje SME duke u krijuar 36 vende të reja të punës.

Në kategorinë e ndihmës horizontale përfshihet gjithashtu ndihma për SME-të. Për vitin 2013 ndërmarrjet e vogla dhe të mesme kanë përfituar ndihmë shtetërore nëpërmjet skemës së fondit të konkurrueshmërisë[12] si edhe fondit të inovacionit[13] respektivisht në shumën 6.59 mln lekë dhe 1.39 mln lekë. Nëpërmjet fondit të konkurrueshmërisë kanë përfituar gjithsej 8 ndërmarrje, të cilat kryejnë aktivitet ekonomik në sektorin e industrisë së lehtë përpunuese, ndërsa nga fondi i inovacionit kanë përfituar gjithsej 7 ndërmarrje në formën e kontraktimit të ekspertëve auditues për teknologjinë dhe inovacionin.

2.3.2. Ndihma shtetërore sektoriale

Në vitin 2013 ndihma shtetërore sektoriale në vlerë absolute është 1.139,61 mln lekë (8,12 mln euro), 55 % më pak krahasuar me vitin 2012. Pesha për këtë kategori në totalin e ndihmës në vitin 2013 është ulur në 5.65 % nga 11.69 % që ishte në vitin 2012.

Tabela nr. 5: Ndihma shtetërore sektoriale 2011-2013 (mln lekë/mln euro)

Burimi: Drejtoria e Tregut të Brendshëm, MZHETS

| Ndihma sektoriale | 2011 | | 2012 | | 2013 | | ndryshimi 2012/2011 | ndryshimi 2013/2012 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | mln LEK | mln EUR | mln LEK | mln EUR | mln LEK | mln EUR | | |
| kursi mes. i këmbimit | | 140,33 | | 139,04 | | 140,27 | | |
| Transporti publik | 452,00 | 3,22 | 440,00 | 3,16 | 440,00 | 3,14 | 97,35 | 100,00 |
| Shërbime publike | 773,00 | 5,51 | 787,00 | 5,66 | 600,00 | 4,28 | 101,81 | 76,24 |
| Minerat | 5,00 | 0,04 | 13,00 | 0,09 | 13,90 | 0,10 | 260,00 | 106,92 |
| Energjia | 1.161,97 | 8,28 | 1.268,50 | 9,12 | 85,71 | 0,61 | 1,09 | 6,76 |
| Televizionet/mediat | 2,89 | 0,02 | 2,89 | 0,02 | - | - | 1,00 | - |
| Turismi | - | - | - | - | - | - | - | - |
| **TOTAL** | **2.394,86** | **17,07** | **2.511,39** | **18,06** | **1.139,61** | **8,12** | **104,87** | **45,38** |

Grafiku nr. 5: Ecuria e ndihmës shtetërore sektoriale (mln euro)




Të dhënat në tabelën nr. 5, tregojnë se ndihma shtetërore sektoriale gjithsej në vitin 2013 është ulur me 45.38 % kundrejt vitit 2012, dhe e përgjysmuar kundrejt vitit 2011.

6 Vendim i KNSH-së nr. 17, datë 16.7.2007 "Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së makinerive dhe pajisjeve të importuara, si dhe të energjisë elektrike të importuar nga KESH sh.a."

7 Vendim i KNSH-së nr. 25, datë 2.5.2008 "Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për përjashtimin nga akciza të lëndëve djegëse, të përdoruara për prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet me fuqi më të madhe se 5 MW", i ndryshuar me vendimin e KNSH-së nr. 27, datë 18.8.2008

8 Vendim i KNSH-së nr. 24, datë 2.5.2008 "Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale të cilat përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit"

9 Vendimi i KNSH-së nr. 12, datë 15.3.2007 "Për skemën ekzistuese "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë""

10 Vendimi i KNSH-së nr. 11, datë 15.3.2007 "Për skemën ekzistuese "Për programin e nxitjes së punësimit, të punëkërkuesve të papunë""

11 Vendimi i KNSH-së nr. 38, datë 19.9.2011 "Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore "Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta""

12 Vendimi i KNSH-së nr. 10, datë 2.2.2007 "Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për grantin "Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë"".

13 Vendimi i KNSH-së nr. 44 datë 11.9.2012 "Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore "Për krijimin e fondit të inovacionit""

Grafiku nr. 7: Struktura e ndihmës shtetërore sektoriale 2011- 2013

Burimi: Drejtoria e Tregut të Brendshëm, MZHETS




Në strukturën e ndihmës sektoriale (vertikale) për vitin 2013, peshën më të lartë e zë ndihma për shërbimet publike (ndihma për sektorin e ujësjellës - kanalizimeve), e ndjekur nga ndihma për transportin publik (hekurudha) dhe ndihma për minierat. Në vitin 2013 ndihma për shërbimet publike është dhënë në masën 600 milionë lekë, një subvencionim nga buxheti i shtetit si mbështetje për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve me qëllim mbulimin e një pjese të kostove operacionale [14] për ndërmarrjet me kapital shtetëror. Ndihma për energjinë është dhënë në masën 85,71 milionë lekë.

Për sa i takon transportit publik ndihma shtetërore është dhënë nga buxheti i shtetit për mbështetjen e transportit hekurudhor, i cili nuk ndryshon me vlerën e subvencionit të akorduar në vitin 2012.

2.4. Instrumentet e shpërndarjes së ndihmës shtetërore

Ndihma shtetërore e dhënë nga burime shtetërore, në varësi të llojit (instrumentit) të përdorur, përbën një shpenzim real apo potencial të pasurisë publike duke patur një efekt në mbledhjen e të ardhurave publike. Në vitin 2013, ndihma shtetërore është dhënë kryesisht në formën e subvencioneve dhe lehtësirat tatimore. Referuar metodologjisë së përdorur nga BE, instrumentet e ndihmës shtetërore klasifikohen në:

A1 - Subvencione dhe grante;

A2- Përjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale;

B - Pjesëmarrja në kapital;

C1 - Hua të buta;

C2 - instrumente të tjera;

D – Garancitë.

Tabela nr. 6: Ndihma shtetërore gjithsej e klasifikuar sipas instrumenteve

Burimi: Drejtoria e Tregut të Brendshëm, MZHETS

| | | Kategoria e ndihmës | Subvencione dhe Grante (A1) | Përjashtim nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale (A2) | Të tjera instrumente (C 2) | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| I | | **Ndihmat horizontale** | | | | **17.883** |
| | 1 | Punësimi | 21,10 | | | 21,10 |
| | 2 | Ndihma operacionale | | 1.160,12 | | 1.160,12 |
| | 3 | Kërkimi dhe Zhvillimi | | 16.629,32 | | 16.629,32 |
| | 4 | SME-të | 7,98 | | | 7,98 |
| | 5 | Trainimi | 64,80 | | | 64,80 |
| II | | **Ndihma sektoriale** | | | | **1.139,61** |
| | 6 | Transporti publik | 440,00 | | | 440,00 |
| | 7 | Shërbimet publike | 600,00 | | | 600,00 |
| | 8 | Minierat | 13,90 | | | 13,90 |
| | 9 | Energjia | | 85,71 | | 85,71 |
| | 10 | Televizionet/mediat | | | - | - |
| | | **TOTALI** | **1.147,78** | **17.875,15** | **-** | **19.022,93** |

Të dhënat në tabelë tregojnë se instrumenti i përdor më shpesh është A1 - Subvencione dhe grante dhe Instrumenti A 2- lehtësira tatimore.

Grafiku nr.7: Struktura e shpërndarjes të instrumenteve të ndihmës shtetërore për vitin 2013 në %




Grafiku paraqet pjesën që zë çdo instrument i përdorur për dhënien e ndihmës shtetërore.

[14] Vendim KNSH nr. 5, datë 20.10.2006 "Për skemën ekzistuese të subvencionimit të ndërmarrjeve të ujësjellësit"

3. PËRMBLEDHJE

Raporti vjetor 2013 për ndihmën shtetërore në Shqipëri është hartuar në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian në fushën e raportimit të ndihmës shtetërore.

Ndihma shtetërore përfshirë sektorin e bujqësisë dhe peshkimit në vitin 2013 është dhënë në vlerën totale prej 20.178,13 mln lekë (143,85 mln euro).

Ndihma shtetërore përjashtuar sektorin e bujqësisë dhe peshkimit në vitin 2013 është dhënë në vlerën totale prej 19.021,23 mln lekë (135, 6 mln euro).

Ndihma shtetërore në vlerë absolute e dhënë në vitin 2013 është 6 % më pak në krahasim me vitin 2012, dhe 22 % më i lartë në krahasim me ndihmën shtetërore në vitin 2011. Përqindja e raportit të ndihmës shtetërore ndaj PBB-së zbriti nga 1.62 % në 2012 në 1.49 % në vitin 2013.

Në vitin 2013 ndihma shtetërore horizontale në vlerë absolute është 17. 881,57 mln lekë (127,48 mln euro) dhe e rritur me 6.4 % krahasuar me vitin 2012. Pesha për këtë kategori në totalin e ndihmës në vitin 2013 është rritur me 10 % krahasuar me vitin 2012.

Në vitin 2013 ndihma shtetërore sektoriale në vlerë absolute është 1. 139,61 mln lekë (8,12 mln euro), 55 % më pak krahasuar me vitin 2012. Pesha për këtë kategori në totalin e ndihmës në vitin 2013 është ulur në 5.65 % nga 11.69 % që ishte në vitin 2012.

Ndihma shtetërore për vitin 2013 ka vijuar trendin e vitit 2012, konkretisht:

- Rritje të ndihmës shtetërore për kërkim dhe zhvillim, e cila përfshihet në kategorinë e ndihmës horizontale, duke sjellë pasoja të vogla në konkurrencë.
- Instrumentet e përdorura më shumë janë: A1 - Subvencione dhe grante dhe Instrumenti A2 - Përjashtime nga taksat, shtyrje e taksave, ulje e normës së taksave.

Paraqitja dhe vlerësimi i të dhënave të ndihmës shtetërore në këtë raport është parë në një kontekst dinamik, duke marrë parasysh zhvillimin ekonomik të vendit. Në varësi të objektivave strategjikë dhe përparësive në zhvillimin e politikës industriale për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, ka të ngjarë që modelet e shpërndarjes së skemave të ndihmës, në të ardhmen, të ndryshojnë. Raporti u tregon apo u sugjeron autoriteteve shqiptare të përgatisin skema të projektuara dhe orientuara në bazë të zhvillimit shumëvjeçar dhe që të synojnë kryesisht drejt realizimit të objektivave horizontalë dhe me ndikim në shumë sektorë ekonomisë apo rajone të vendit.

Raporti vjetor për ndihmat shtetërore për vitin 2013 përfshin gjithashtu të dhënat për ndihmën në sektorin e bujqësisë dhe peshkimit, edhe pse ky sektor nuk bën pjesë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore".

**VENDIM**
**Nr. 366, datë 11.6.2014**

## PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË SIPËRFAQEVE PYJORE E KULLOSORE QË DO TË PËRDOREN NGA SHOQËRIA TAP-AG PËR NDËRTIMIN E RRJETIT RRUGOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, të pikës 4 të nenit 10 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kullosor" dhe të ligjit nr. 116/2013, "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe TAP-AG", me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor dhe çregjistrimin nga kadastra e pyjeve dhe kullotave të sipërfaqes pyjore e kullosore prej 51,93 (pesëdhjetë e një presje nëntëdhjetë e tre) ha, që do të përdoret nga shoqëria TAP-AG për ndërtimin e rrjetit rrugor në funksion të ndërtimit të gazsjellësit TAP-AG.

Sipërfaqja pyjore e kullosore që hiqet nga fondi pyjor dhe kullosor jepet në lidhjen 1 (një) që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Heqja nga fondi pyjor dhe kullosor për ndërtimin e rrjetit rrugor të gazsjellësit TAP-AG, të bëhet me pjesë sipas territoreve administrative të njësive të qeverisjes vendore, bazuar në grafikun e parashikuar për realizimin e këtij projekti.

3. Shoqëria TAP-AG, pas përfundimit të punimeve për ndërtimin e rrjetit rrugor pjesor, sipas pikës 2 të këtij vendimi, është e detyruar të realizojë rehabilitimin mjedisor të territorit pyjor dhe kullosor.

4. Vlerat përkatëse të pakësimit në volum të lëndës drusore dhe produkteve të tjera pyjore, sipërfaqet dhe investimet e kryera në vite në pyje dhe kullota, objekt i këtij vendimi, paguhen nga shoqëria TAP-AG, sipas lidhjes 4, bashkëlidhur vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", të ndryshuar.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria TAP-AG, brenda 5 (pesë) viteve, të pyllëzojë me fondet e veta 50,23 (pesëdhjetë presje njëzet e tre) ha sipërfaqe me drurë pyjorë, në ekonomitë pyjore dhe kullosore të përcaktuara në marrëveshjen e lidhur ndërmjet shoqërisë TAP-AG dhe Ministrisë së Mjedisit.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, bëhen ndryshimet përkatëse në regjistrin e kadastrës pyjore dhe kullosore dhe në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

7. Ministria e Mjedisit dhe shoqëria TAP-AG nënshkruajnë marrëveshje të përbashkët mbi hapat, afatet dhe procedurat për hartimin e projekteve teknike të heqjes së materialit drusor dhe pyllëzimin e sipërfaqeve pyjore sipas pikës 5 të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, njësitë e qeverisjes vendore në territoret e të cilave kalon rrjeti rrugor për ndërtimin e gazsjellësit TAP-AG dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

LISTA E NGASTRAVE DHE NËNNGASTRAVE QË HIQEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR NDËRTIMIN E RRUGËS NDIHMËSE TË GAZSJELLËSIT "TAP-AG"

Qarku Berat

Lidhja nr. 1

| ID e pronës | Ekonomi pyjore | Ngastra | Administrimi | Sipërfaqe që preket nga gjurma (ha) |
|---|---|---|---|---|
| BR24 | Ekonomi pyjore -Liqeth-Vale | 80a | Pronësi K.Vendreshe | 0.92 |
| BR24 | Ekonomi pyjore -Liqeth-Vale | 22a | Pronësi K.Vendreshe | 0.22 |
| BR24 | Ekonomi pyjore -Liqeth-Vale | 20 | Pronësi K.Vendreshe | 0.09 |
| BR24 | Ekonomi pyjore -Liqeth-Vale | 19a | Pronësi K.Vendreshe | 0.29 |
| BR24 | Ekonomi pyjore -Liqeth-Vale | 29a | Pronësi K.Vendreshe | 0.20 |
| BR24 | Ekonomi pyjore -Liqeth-Vale | 59a | Pronësi K.Vendreshe | 0.43 |
| BR24 | Ekonomi pyjore -Liqeth-Vale | 61a | Pronësi K.Vendreshe | 1.37 |
| BR24 | Ekonomi pyjore -Liqeth-Vale | 67 | Pronësi K.Vendreshe | 0.96 |
| BR24 | Ekonomi pyjore -Liqeth-Vale | 68 | Pronësi K.Vendreshe | 0.47 |
| BR24 | Ekonomi pyjore -Liqeth-Vale | 81a | Admin.DSHPyjor | 0.50 |
| BR24 | Ekonomi pyjore -Liqeth-Vale | 86a | Admin.DSHPyjor | 0.29 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 81a | Admin.DSHPyjor | 0.37 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 81c | Admin.DSHPyjor | 0.08 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 81d | Admin.DSHPyjor | 0.15 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 84a | Pronesi K.Qender | 0.04 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 85a | Admin.DSHPyjor | 0.46 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 86a | Admin.DSHPyjor | 0.56 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 102a | Admin.DSHPyjor | 0.04 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 95a | Admin.DSHPyjor | 0.16 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 96a | Admin.DSHPyjor | 0.57 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 97a | Admin.DSHPyjor | 0.77 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 98a | Admin.DSHPyjor | 0.69 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 99a | Admin.DSHPyjor | 0.13 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 89a | Admin.DSHPyjor | 0.88 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 90a | Admin.DSHPyjor | 2.23 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 88a | Pronesi K.Qender | 0.64 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 87a | Pronesi K.Qender | 2.19 |
| BR32 | Ekonomi pyjore Sijov-Guhak | 87b | Admin.DSHPyjor | 0.15 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 54a | Admin.DSHPyjor | 0.15 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 49b | Admin.DSHPyjor | 0.51 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 49c | Admin.DSHPyjor | 0.30 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 48a | Admin.DSHPyjor | 0.63 |
| BR32 | Ekonomi pyjore -Sijov-Guhak | 48b | Admin.DSHPyjor | 0.15 |
| BR33 | Ekonomi pyjore -Turbuhov-Potom | 71 | Admin.DSHPyjor | 1.42 |
| BR34 | Ekonomi pyjore -Turbuhov-Potom | 85a | Admin.DSHPyjor | 0.86 |
| BR33 | Ekonomi pyjore -Turbuhov-Potom | 88 | Admin.DSHPyjor | 0.45 |
| BR33 | Ekonomi pyjore -Turbuhov-Potom | 86a | Admin.DSHPyjor | 2.72 |
| BR33 | Ekonomi pyjore -Turbuhov-Potom | 86d | Admin.DSHPyjor | 0.12 |
| BR33 | Ekonomi pyjore -Turbuhov-Potom | 87a | Admin.DSHPyjor | 0.46 |
| BR33 | Ekonomi pyjore -Turbuhov-Potom | 46 | Pronesi K.Leshnje | 0.42 |
| BR33 | Ekonomi pyjore -Turbuhov-Potom | 48a | Pronesi K.Leshnje | 0.57 |
| BR33 | Ekonomi pyjore -Turbuhov-Potom | 49a | Pronesi K.Leshnje | 0.94 |
| BR01 | Ekonomi kullosore -Backe | 6 | Admin.DSHPyjor | 1.08 |
| BR01 | Ekonomi kullosore -Backe | 7 | Admin.DSHPyjor | 1.28 |
| BR01 | Ekonomi kullosore -Backe | 11 | Admin.DSHPyjor | 0.79 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| BR01 | Ekonomi kullosore -Backe | 12 | Admin.DSHPyjor | 1.20 |
| BR04 | Ekonomi kullosore -Kapinove | 24 | Admin.DSHPyjor | 0.38 |
| BR01 | Ekonomi kullosore -Backe | 23 | Admin.DSHPyjor | 0.23 |
| BR01 | Ekonomi kullosore -Backe | 22 | Admin.DSHPyjor | 1.29 |
| Totali: Pyje | | | | 25.54 |
| Totali: Kullota | | | | 6.25 |
| Totali i qarkut Berat-(pyje dhe kullota) | | | | 31.79 |

Qarku Korçë

| ID Pronës | Ekonomi pyjore | Ngastra | Administrimi | Sip. që preket nga gjurma (ha) |
|---|---|---|---|---|
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 8 | Admin.DSHPyjor | 0.3 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 9 | Admin.DSHPyjor | 0.6 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 10b | Admin.DSHPyjor | 0.5 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 11a | Admin.DSHPyjor | 0.02 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 12b | Admin.DSHPyjor | 0.5 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 13a | Admin.DSHPyjor | 0.06 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 13b | Admin.DSHPyjor | 0.22 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 14 | Admin.DSHPyjor | 1.2 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 15 | Admin.DSHPyjor | 0.3 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 16 | Admin.DSHPyjor | 0.4 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 17 | Admin.DSHPyjor | 0.3 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 19b | Admin.DSHPyjor | 0.07 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 19c | Admin.DSHPyjor | 0.3 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 21b | Admin.DSHPyjor | 0.6 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 22b | Admin.DSHPyjor | 0.09 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 24b | Admin.DSHPyjor | 0.09 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 25b | Admin.DSHPyjor | 0.7 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 26b | Admin.DSHPyjor | 0.7 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 27a | Admin.DSHPyjor | 0.09 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 28b | Admin.DSHPyjor | 0.2 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 29a | Admin.DSHPyjor | 0.2 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 29c | Admin.DSHPyjor | 0.3 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 30b | Admin.DSHPyjor | 0.4 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 31c | Admin.DSHPyjor | 0.4 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 32a | Admin.DSHPyjor | 0.5 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 33a | Admin.DSHPyjor | 0.2 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 33b | Admin.DSHPyjor | 0.2 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 34b | Admin.DSHPyjor | 0.3 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 35a | Admin.DSHPyjor | 0.002 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 35b | Admin.DSHPyjor | 0.3 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 36a | Admin.DSHPyjor | 0.3 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 37a | Admin.DSHPyjor | 0.9 |
| KO64 00 | Ekonomi pyjore Sherre-Panarit | 37b | Admin.DSHPyjor | 0.6 |
| KO52 00 | Ekonomi pyjore Panarit-Treske | 37c | Admin.DSHPyjor | 0.2 |
| KO52 00 | Ekonomi pyjore Panarit-Treske | 38a | Admin.DSHPyjor | 0.9 |
| KO52 00 | Ekonomi pyjore Panarit-Treske | 14b | Admin.DSHPyjor | 0.8 |
| KO66 03 | Ekonomi pyjore Panarit-Treske | 24 | Admin.DSHPyjor | 2.5 |
| KO66 03 | Ekonomi pyjore Vithk-Lubonje | 27 | Admin.DSHPyjor | 0.1 |
| KO66 03 | Ekonomi pyjore Vithk-Lubonje | 29 | Admin.DSHPyjor | 1.3 |
| KO66 03 | Ekonomi pyjore Vithk-Lubonje | 30 | Admin.DSHPyjor | 0.2 |
| KO66 03 | Ekonomi pyjore Vithk-Lubonje | 18a | Admin.DSHPyjor | 0.3 |
| KO66 03 | Ekonomi pyjore Vithk-Lubonje | 18b | Admin.DSHPyjor | 1.1 |
| KO66 03 | Ekonomi pyjore Vithk-Lubonje | 18c | Admin.DSHPyjor | 0.8 |
| KO66 03 | Ekonomi pyjore Vithk-Lubonje | 18d | Admin.DSHPyjor | 0.1 |
| Totali Pyje | | | | 16.84 |
| Totali: Kullota | | | | 3.3 |
| Totali i Qarkut Korçë-(pyje dhe kullota) | | | | 20.14 |
| **GJITHSEJ-PYJE DHE KULLOTA** | | | | **51.9315** |

**VENDIM**
**Nr. 367, datë 11.6.2014**

## PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 1701, DATË 17.12.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E DHËNIES SË AUTORIZIMEVE PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE TË REJA GJENERUESE TË ENERGJISË, QË NUK JANË OBJEKT KONCESIONI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 34/1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në rregulloren "Për procedurat e dhënies së autorizimeve për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë, që nuk janë objekt koncesioni", të miratuar me vendimin nr. 1701, datë 17.12.2008, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 të nenit 2, fjalët "… dhe që lidhen me rrjetet e transmetimit dhe/ose shpërndarjes …" shfuqizohen.

2. Pika 1 e nenit 4 të rregullores ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Çdo person që zhvillon veprimtari tregtare sipas legjislacionit shqiptar, duke përfshirë edhe shoqëritë tregtare të kontrolluara nga shteti, mund të aplikojë për marrjen e një autorizimi për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese.".

3. Pas pikës 1 të nenit 18 shtohet pika 2, me këtë përmbajtje:

"2. Përmbushja e kushtit të përcaktuar në shkronjën "m" të pikës 1 nuk është e nevojshme, në rastin kur aplikimi për ndërtimin e një burimi gjenerues bëhet nga një shoqëri tregtare e kontrolluar nga shteti, e cila do ta përdorë energjinë e prodhuar për plotësimin e nevojave të veta.".

4. Në nenin 20 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Shkronja "d" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"d) miratimin e OST-së ose OSSH-së për pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose shpërndarjes sipas kërkesave të kodit të transmetimit ose shpërndarjes, për rastet kur burimi parashikohet të lidhet me rrjetin e transmetimit ose shpërndarjes.".

b) Shkronja "e" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"e) lejet dhe autorizimet mjedisore nga institucionet përgjegjëse vendore ose kombëtare, për rastet kur përmbushja e këtij kushti kërkohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.".

c) Shkronja "f" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"f) dokumentacionin ligjor, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, që provon marrëdhënien afatgjatë mbi truallin që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues.".

5. Në nenin 22 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja "d" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"d) afatin e ndërtimit të burimit gjenerues.".

b) Në shkronjën "e", fjalët "…studimit të…" shfuqizohen.

c) Në fillim të shkronjës "j" shtohen fjalët "Përveç rasteve të parashikuara në pikën 2 të nenit 18 …".

ç) Pas shkronjës "k" shtohet shkronja "l", me këtë përmbajtje:

"l) afatin maksimal të shfrytëzimit të burimit gjenerues.".

Ngarkohet ministri i Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 371, datë 11.6.2014**

## PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR DORËZIMIN E MBETJEVE TË RREZIKSHME DHE TË DOKUMENTIT TË DORËZIMIT TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 26 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre, në mënyrë profesionale, nga një person tek një tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Mbetje të rrezikshme klasifikohen mbetjet e shënuara me shenjën yll "*", të miratuara me vendimin nr. 99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Mbetjeve".

3. Termat e përdorur në këtë vendim kanë kuptimin e dhënë në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, në ligjin nr. 118/2012, "Për transportin e mallrave të rrezikshme", në ligjin nr. 9108, datë 17.7.2003, "Për substancat dhe preparatet kimike", në ligjin nr. 9272, datë 16.9.2004,"Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen evropiane "Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)"

dhe protokollin e nënshkrimit", Gjenevë, më 30 shtator 1957, me pjesët e saj përbërëse, anekset A dhe B, si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 18.2.2005, "Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Mbetjeve" (në vijim "Katalogu i Mbetjeve"), ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Dorëzues", krijuesi i mbetjeve të rrezikshme, grumbulluesi, agjenti ose tregtari.

b) "Marrësi", personi pritës i mbetjeve të rrezikshme i cili i merr në dorëzim mbetjet e rrezikshme nga transportuesi.

c) "Transportuesi", subjekti, i cili transferon mbetjen e rrezikshme nga dorëzuesi tek marrësi në dorëzim.

4. Dorëzimi i mbetjeve të rrezikshme nga një person tek një person tjetër bëhet pas plotësimit të dokumentit të dorëzimit, sipas shtojcave 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Dorëzuesi, transportuesi dhe marrësi i mbetjeve të rrezikshme janë persona, fizikë ose juridikë, të pajisur me lejen e mjedisit sipas fushës III.1, të shtojcës së ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", dhe me licencën III.2.B, të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta".

6. Kur transporti i mbetjeve të rrezikshme kryhet nga transportues të licencuar për të tretë ose me qira, ai është i mbështetur mbi kontratën e transportit midis palëve, në të cilën përcaktohet detyrimisht personi përgjegjës për garantimin e mbërritjes në destinacion të mbetjeve të rrezikshme brenda afateve të përcaktuara në pikën 11 të këtij vendimi. Kur transporti i mbetjeve të rrezikshme kryhet me mjetet e vetë dorëzuesit apo të marrësit, kontrata mbi transportin nuk është e nevojshme.

7. Përpara largimit të mbetjes/mbetjeve të rrezikshme nga vendi ku gjenerohet/gjenerohen, dorëzuesi i saj/tyre plotëson dokumentin e dorëzimit në aq kopje sa janë personat që e nënshkruajnë atë.

8. Dokumenti i dorëzimit plotësohet dhe nënshkruhet nga dorëzuesi, transportuesi dhe marrësi i mbetjeve të rrezikshme.

9. Dorëzuesi, për çdo transfertë, u dërgon nga një kopje të dokumenteve të dorëzimit, të plotësuar dhe të nënshkruar nga palët, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave.

10. Dorëzuesi plotëson të dhënat që kërkohen në pjesët "A", "B" dhe "D" të dokumentit të dorëzimit; transportuesi plotëson të dhënat që kërkohen në pjesën "C" të këtij dokumenti, dhe marrësi plotëson ato që kërkohen në pjesën "E" të dokumentit të dorëzimit.

11. Transportuesi dorëzon mbetjet e rrezikshme tek marrësi brenda 72 orëve nga data e nisjes, sipas përcaktimit në pjesën "C/13" të dokumentit të dorëzimit.

12. Në rast se transportuesi është në pamundësi të respektimit të këtij afati, për shkaqe teknike të automjetit ose për shkaqe shëndetësore të drejtuesit të mjetit, ai njofton menjëherë dërguesin dhe marrësin e mbetjeve të rrezikshme në numrat e telefonit apo me mënyrat e komunikimit të parashikuara sipas shtojcës 1 bashkëlidhur, dhe merr masat për sigurimin e një transporti alternativ, në përmbushje të afatit kohor të përcaktuar në pikën 11 të këtij vendimi.

13. Marrësi në dorëzim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së mbetjeve të rrezikshme, i dërgon dorëzuesit konfirmimin me shkrim për marrjen e mbetjeve dhe dokumentin e dorëzimit në dy kopje, të plotësuar dhe të nënshkruar nga personat e përcaktuar në pikën 8 të këtij vendimi.

14. Komunikimi ndërmjet personave që angazhohen në procesin e dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme bëhet në formë shkresore ose në formë elektronike. Dokumenti i dorëzimit është i vlefshëm në formë elektronike vetëm nëse është plotësuar dhe nënshkruar nga personat e përcaktuar në pikën 8 të këtij vendimi.

15. Marrësi, në rastin kur refuzon të marrë në dorëzim, plotësisht apo pjesërisht, ngarkesën me mbetje të rrezikshme, informon me shkrim dërguesin për arsyet e refuzimit dhe plotëson pjesën "E/3" të dokumentit të dorëzimit, duke specifikuar llojin e mbetjes së rrezikshme, kodin sipas Katalogut të Mbetjeve, sasinë dhe formën fizike të mbetjes/mbetjeve të rrezikshme që refuzohet, sipas specifikimeve të dhëna në pjesët "B/3" dhe "B/4" të dokumentit të dorëzimit.

16. Transportuesi, në rastet kur marrësi refuzon plotësisht apo pjesërisht marrjen në dorëzim të ngarkesës, i kthen mbetjet e rrezikshme tek dorëzuesi brenda72 orëve nga dita e refuzimit.

17. Dokumenti i dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme shoqëron çdo dorëzim të këtyre mbetjeve deri në destinacionin përfundimtar dhe të dhënat regjistrohen në Regjistrin e Transfertave Individuale, që krijohet për këtë qëllim.

18. Agjencia Kombëtare e Mjedisit krijon Regjistrin Kombëtar të Transfertave të Mbetjeve të Rrezikshme.

19. Mënyra e administrimit dhe formati i Regjistrit të Transfertave Individuale dhe ai i Regjistrit Kombëtar të Transfertave miratohen me urdhër të ministrit.

20. Dokumenti i dorëzimit përmban kodin unik, i cili përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë e kodit unik miratohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pas paraqitjes së kërkesës me shkrim nga dorëzuesi. Kërkesa shoqërohet me kopje të ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

21. Agjencia Kombëtare e Mjedisit miraton pjesën e

parë të kodit unik brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës.

22. Pjesa e parë e kodit unik është individuale dhe e papërsëritshme për çdo subjekt që transferon mbetje të rrezikshme. Pjesa e dytë e kodit unik vendoset nga vetë dorëzuesi dhe ndryshon për çdo transfertë.

23. Përcaktimi i kodit unik bëhet sipas metodologjisë në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

24. Agjencia Kombëtare e Mjedisit krijon një bazë të dhënash për kodet unike, si pjesë të Regjistrit Kombëtar të Transfertave të Mbetjeve të Rrezikshme.

25. Mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas përcaktimeve të nenit 62 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar.

26. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

SHTOJCA 1
DOKUMENTI I DORËZIMIT PËR MBETJE TË RREZIKSHME

| | | |
|---|---|---|
| | | **Kopja e dërguesit të ngarkesës**<br>**Kopja e transportuesit**<br>**Kopja e marrësit të ngarkesës**<br>**(Ruani vetëm emërtimin që është i vërtetë dhe fshini atë që është i tepërt.)** |
| **Pjesa A. Detajet e njoftimit** | | |
| 1 | Kodi unik i dokumentit të dorëzimit | |
| 2 | Mbetjet e rrezikshme të përshkruara në pjesën B do të largohen nga dorëzuesi (krijuesi): | |
| | a) Emri | |
| | b) Adresa | |
| | c) Telefoni | |
| | d) E-maili | |
| | e) Faksi | |
| | f) Numri i regjistrimit (NIPT) | |
| | g) Nr. i lejes së mjedisit III.1 | |
| | h) Nr. e licencës të tipit III.2 B | |
| 3 | Mbetjet e rrezikshme do të dërgohen tek: | |
| | a) Emri | |
| | b) Adresa | |
| | c) Telefoni | |
| | d) E-maili | |
| | f) Faksi | |
| 4 | Dorëzuesi i mbetjeve të rrezikshme (nëse është i ndryshëm nga krijuesi) është (grumbulluesi, agjenti ose tregtari) zgjidh cili jeni: | |
| | a) Emri | |
| | b) Adresa | |
| | c) Telefoni | |
| | d) E-maili | |
| | e) Faksi | |
| | f) Numri i regjistrimit (NIPT) | |
| | g) Nr. i lejes së mjedisit III.1 | |
| | h) Nr. e licencës të tipit III.2.B | |
| 5 | a) Emri | |
| | b) Adresa | |
| | c) Telefoni | |
| | d) E-maili | |
| | e) Faksi | |
| | f) Numri i regjistrimit (NIPT) | |
| | g) Nr. i lejes së mjedisit III.1 | |
| | h) Nr. e licencës të tipit III.2.B | |
| **Pjesa B. Përshkrimi i mbetjeve të rrezikshme** | | |
| 1 | Procesi/veprimtaria që krijoi (gjeneroi) mbetje të rrezikshme ishte: | |
| 2 | Detaje për mbetjet:<br>(Kur grumbullohet më shumë se një lloj mbetjeje, gjithë informacioni i mëposhtëm duhet plotësuar për secilën mbetje të identifikuar sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve) | |

(Vazhdoni në fletë të re nëse është e nevojshme)

| **Përshkrimi i mbetjes** | **Kodi (6-shifror) sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve** | **Sasia (kg)** | **Komponentët kimikë/ biologjikë të mbetjeve dhe përqendrimet e tyre janë:** | | **Forma fizike (e gaztë, e lëngët, e ngurtë, pluhur, llum apo e përzier** | **Kodi (kodet) e rrezikut** | **Lloji i kontenierit, numri dhe madhësia)** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Komponenti** | **Përqendrimi (% ose mg/kg)** | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |

3 Mbetjet, të identifikuara sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve, të plotësohen sipas informacionit të mëposhtëm:

| **Kodi sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve** | **Lloji i (e) ambalazhit (p.sh. palët, fuçi, kontejner etj.)** | **Lloji i transportit të duhur (rrugor ose hekurudhor)** | **Kërkesa të veçanta gjatë transportit** | **Tipi i automjetit** | **Numri UN** |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

**Pjesa C. Vërtetimi i transportuesit**

Vërtetoj se sot mora ngarkesën dhe se detajet në pjesët A2, A3 dhe B2, dhe, sipas rastit, B3, janë të sakta dhe jam vënë në dijeni për çdo kërkesë specifike për trajtimin e tyre.

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Emri | |
| 2 | Në emër të (emri i kompanisë) | |
| 3 | Emri i kompanisë | |
| 4 | Adresa e kompanisë | |
| 5 | Telefoni i kompanisë | |
| 6 | E-maili i kompanisë | |
| 7 | Faksi i kompanisë | |
| 8 | Numri i regjistrimit të transportuesit (NIPT) | |
| 9 | Numri i regjistrimit të automjetit (targa) | |
| 10 | Nr. i lejes së mjedisit III.1 | |
| 11 | Nr. e licencës të tipit III/2 B | |
| 12 | Nr. i certifikatës së miratimit të mjetit sipas ADR ose RID<br>Data e miratimit dhe e mbarimit të afatit të vlefshmërisë së certifikatës | |
| 13 | Nënshkrimi | |
| 14 | Data e nisjes | |
| 15 | Ora e nisjes | |

**Pjesa D. Vërtetimi i dorëzuesit të ngarkesës**

Vërtetoj se informacioni në pjesët A, B dhe C është i saktë. Transportuesi është i regjistruar dhe është vënë në dijeni për të gjitha masat e duhura përkujdesëse. Gjithashtu vërtetoj se të gjitha mbetjet e rrezikshme janë ambalazhuar dhe etiketuar siç duhet dhe transportuesi është vënë në dijeni për çdo kërkesë specifike për mënyrën e transportimit të tyre.

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Emri | |
| 2 | Në emër të (emri i kompanisë) | |
| 3 | Emri i kompanisë | |
| 4 | Adresa e kompanisë | |
| 5 | Telefoni i kompanisë | |
| 6 | E-maili i kompanisë | |
| 7 | Faksi i kompanisë | |
| 8 | Nënshkrimi | |
| 9 | Data e dorëzimit | |
| 10 | Ora e dorëzimit | |

**Pjesa E. Vërtetimi i marrësit të ngarkesës**

Në rastet kur merret më shumë se një lloj mbetjeje, i gjithë informacioni i mëposhtëm duhet plotësuar për çdo mbetje të Katalogut Shqiptar të Mbetjeve.

| **Kodi(et) i (e) mbetjeve të marra në dorëzim sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve** | **Sasia e marrë në dorëzim (kg) për çdo kod sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve** | **Kodi i mbetjeve të refuzuara sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve** | **Sasia e mbetjeve të refuzuara** | **Operacioni i menaxhimit të mbetjeve (kodi R ose D)** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Vërtetoj se i kam marrë këto mbetje në adresën e dhënë në pjesën A3 më: | |
| | Data e marrjes | |
| | Ora e marrjes | |
| 2 | Numri i regjistrimit të automjetit (targa) | |
| 4 | Vërtetoj se leja e mjedisit autorizon menaxhimin e mbetjeve të përshkruara në pjesën B në adresën e dhënë në pjesën A3: | |
| 5 | Numri i lejes së mjedisit | |
| 6 | Numri i licencës III.2.B | |
| 7 | Emri i personit të autorizuar për marrjen e mbetjeve të rrezikshme | |
| 8 | Në emër të (emri i kompanisë) | |
| 9 | Emri i kompanisë | |
| 10 | Adresa e kompanisë | |
| 11 | Telefoni i kompanisë | |
| 12 | E-maili i kompanisë | |
| 13 | Faksi i kompanisë | |
| 14 | Lutemi jepni detaje, për rastet kur mbetjet refuzohen: | |
| 15 | Data e refuzimit | |
| 16 | Ora e refuzimit | |
| 17 | Nënshkrimi | |
| 18 | Pikat e kontaktit në rast emergjence gjatë transportit të mbetjeve të rrezikshme:<br>Dërguesi:<br>Transportuesi:<br>Marrësi: | |

## SHTOJCA 2
## METODOLOGJIA E PËRCAKTIMIT TË KODIT UNIK TË DOKUMENTIT TË DORËZIMIT

Kodi unik i dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme përbëhet nga dy pjesë.

**A. Pjesa e parë e kodit unik** përmban 7 karaktere, nga të cilat 3 të parat janë shkronja dhe pjesa tjetër janë numra natyrorë. 3 shkronjat e para janë inicialet e personit fizik ose juridik apo akronimi i emrit të subjektit. 4 numrat fillojnë me 0001 për subjektin që kërkon i pari pajisjen me kodin unik. Më pas vijohet me vendosjen e numrave në rend rritës: 0002; 0003; e në vazhdim.

Shembuj

a) Nëse personi i parë që kërkon pranë AKM-së të pajiset me kodin unik është Elmaz Kujtim Latifi, pjesa e parë e kodit unik do të jetë: EKL0001

b) Nëse personi i dytë që kërkon pranë AKM-së të pajiset me kodin unik është subjekti General Equipments Albania, pjesa e parë e kodit unik do të jetë: GEA0001

**B. Pjesa e dytë e kodit unik** përmban 4 numra, nga të cilët, 2 numrat e parë tregojnë vitin në të cilin kryhet transferta dhe 2 numrat e tjerë tregojnë numrin e transfertës që po kryhet. Pjesa e dytë e kodit unik vendoset nga vetë transferuesi i mbetjeve.

Shembuj

Nëse personi i shembullit të përmendur në shkronjën "a" transferon mbetjet me datën xx.xx.2014 dhe është transferta e parë për vitin kalendarik 2014, pjesa e dytë e kodit unik do të jetë: 1401. Kodi unik në këtë rast do të jetë: EKL00011401.

Nëse personi i shembullit të përmendur në shkronjën "a" transferon mbetjet me datën xx.xx.2014 dhe është transferta e dytë për vitin kalendarik 2014, pjesa e dytë e kodit unik do të jetë: 1402. Kodi unik në këtë rast do të jetë: EKL00011402.

Nëse personi i shembullit "b" më lart transferon mbetjet më datën xx.xx.2015 dhe është transferta e parë për vitin kalendarik 2015, pjesa e dytë e kodit unik do të jetë: 1501. Kodi unik në këtë rast do të jetë: GEA00011501.

Nëse personi i shembullit "b" më lart transferon mbetjet me datën xx.xx.2015 dhe është transferta e dytë për vitin kalendarik 2015, pjesa e dytë e kodit unik do të jetë: 1502. Kodi unik në këtë rast do të jetë: GEA00011502.

## VENDIM
## Nr. 372, datë 11.6.2014

### PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 8, DATË 5.1.2002, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,"PËR KRIJIMIN E KOMITETIT SHTETËROR TË LUFTËS KUNDËR TRAFIKUT TË QENIEVE NJERËZORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999,"Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shfuqizimin e vendimit nr. 8, datë 5.1.2002, të Këshillit të Ministrave,"Për krijimin e Komitetit Shtetëror të Luftës Kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore", të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 373, datë 11.6.2014

### PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, KULTURA BUJQËSORE DHE DRU FRUTORË, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "UNAZA LINDORE SHKODËR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5/1, 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", si dhe në mbështetje të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, kultura bujqësore dhe drurë frutorë, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza lindore Shkodër".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për kultura bujqësore, dru frutorë, me vlerë 1 303 800 (një milion e treqind e tre mijë e tetëqind) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 925 000 (nëntëqind e njëzet e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 1 303 800 (një milion e treqind e tre mijë e tetëqind) lekë, të përballohet nga buxheti i vitit 2014, zëri "Detyrimet e prapambetura (detyrimet e infrastrukturës)".
6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi.
7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.
8. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Proces regjistrimi", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.
9. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve, për efekt shpronësimi, sipas përcaktimeve në pikat 5, 6, 7 dhe 8 të këtij vendimi dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë.
10. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONESIMEVE

**LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I RRUGES " UNAZA LINDORE SHKODER "**
**Drufrutore dhe Vresht**
**Qarku : SHKODER ; Bashkia : SHKODER**

| Nr. | EMRI | ATESIA | MBIEMRI | ZK | NR.PAS | SIPERF. SHPRONESIMI (M2) | DRUFRUTORET VRESHT VLERA (LEKE) | SHENIME |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | LUDOVIK | | KRONI | 8594 | 10/354 | 48,2 | 38500 | Proçes Rregjistrimi |
| 2 | BARDHYL | | ISHMAKU | 8597 | 3/2 | 85 | 39000 | Proçes Rregjistrimi |
| 3 | MARK | | DARCA | 8597 | 3/19 | 45,5 | 13200 | Proçes Rregjistrimi |
| 4 | SOKOL | | OSHKAFI | 8597 | 3/16 | 57,6 | 5500 | Proçes Rregjistrimi |
| 5 | ISMET | | OSMANI | 8597 | 5/15 | 47,1 | 12000 | Proçes Rregjistrimi |
| 6 | AGIM | | PECA | 8597 | 5/10 | 575,7 | 62050 | Proçes Rregjistrimi |
| 7 | TUFIK | | LOPÇI | 8597 | 7/9 | 17,1 | 59750 | Proçes Rregjistrimi |
| 8 | HYSEN | | KURTI | 8597 | 5/13 | 166,7 | 28700 | Proçes Rregjistrimi |
| 9 | ZEF | | SHKAFJA | 8597 | 3/13 | 49,8 | 13000 | Proçes Rregjistrimi |
| 10 | NDUE | | MOLLA | 8597 | 3/30 | 20 | 6500 | Proçes Rregjistrimi |
| 11 | ZALVATOR | | KIÇI | 8593 | 11/299 | 74 | 21000 | Proçes Rregjistrimi |
| 12 | LIN | | PREKA | 8593 | 11/309 | 345,7 | 31700 | Proçes Rregjistrimi |
| 13 | GJERGJ | | GJONI | 8593 | 10/72 | 19 | 5800 | Proçes Rregjistrimi |
| 14 | ALI | | BURGAJ | 8592 | 12/148 | 106,3 | 27000 | Proçes Rregjistrimi |
| 15 | ISA | | MILLA | 8592 | 12/7 | 384,2 | 69600 | Proçes Rregjistrimi |
| 16 | RIFAT | QAMIL | REXHVELAJ | 8592 | 8/319 | 43,6 | 6500 | Proçes Rregjistrimi |
| 17 | ZEF | | PJETRI | 8593 | 11/297 | 82 | 4000 | Proçes Rregjistrimi |
| 18 | BIKE | | PARUNI | 8592 | 8/320 | 59,5 | 6000 | Proçes Rregjistrimi |
| 19 | PREL | | PRONI | 8594 | 10/352 | 87,4 | 58600 | Proçes Rregjistrimi |
| 20 | NDOC | KOLA | MARKU | 8594 | 12/176 | 141 | 39000 | Proçes Rregjistrimi |
| 21 | PAL | | ZEFI | 8594 | 12/171 | 288,8 | 51750 | Proçes Rregjistrimi |
| 22 | NIKE | | ZOGU | 8593 | 15/50 | 5,4 | 10000 | Proçes Rregjistrimi |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 23 | MARTIN | | BARDHOJA | 8594 | 12/56 | 123 | 18000 | Proçes Rregjistrimi |
| 24 | RROK | | LUMA | 8593 | 10/123 | 159 | 22600 | Proçes Rregjistrimi |
| 25 | TONIN | | GJOKA | 8593 | 15/29 | 18,6 | 6600 | Proçes Rregjistrimi |
| 26 | IDRIZ | | ISHMAKU | 8597 | 3/165 | 315,3 | 84200 | Konf. nga ZVRPP |
| 27 | SOKOL | NDUE | BRACI | 8594 | 12/400 | 62,5 | 9000 | Konf. nga ZVRPP |
| 28 | SOKOL | KOL | TAHIRI | 8597 | 3/8+1-4 | 49,6 | 2000 | Konf. nga ZVRPP |
| 29 | FRANO | | SHQAU | 8594 | 9/116 | 98,4 | 23500 | Konf. nga ZVRPP |
| 30 | BARDHOK | | ZHURI | 8597 | 3/5 | 21 | 4000 | Konf. nga ZVRPP |
| 31 | NDUE | | PJETRA | 8593 | 16/231 | 15,7 | 8000 | Konf. nga ZVRPP |
| 32 | GJON+RREGJINA | | KOLNIKAJ | 8593 | 12/12 | 101 | 7800 | Konf. nga ZVRPP |
| 33 | YMER | | BALA | 8592 | 8/4 | 24 | 17000 | Konf. nga ZVRPP |
| 34 | TRASHIGIM | | ÇURÇIJA | 8592 | 10/155 | 65,8 | 7200 | Proçes Rregjistrimi |
| 35 | DEDE &GJON | | BEKA | 8592 | 8/73 | 45,8 | 8000 | Konf.nga ZVRPP |
| 36 | MARK | | ÇUNXHONAJ | 8592 | 8/77 | 289,2 | 17500 | Konf.nga ZVRPP |
| 37 | HAJREDIN | | VAJUSHI | 8592 | 8/2 | 642,2 | 46500 | Konf.nga ZVRPP |
| 38 | LAZER&DEDE&GJON | | BEKA | 8592 | 8/74 | 218 | 103900 | Konf.nga ZVRPP |
| 39 | GEZIM | | TUSHA | 8592 | 8/323 | 182,7 | 31000 | Konf.nga ZVRPP |
| 40 | SHAQIR | | TYRBETARI | 8592 | 8/317 | 61,7 | 18000 | Konf.nga ZVRPP |
| 41 | QEMAL | VIKTOR | FUSHA | 8592 | 8/321 | 102,4 | 28500 | Konf.nga ZVRPP |
| 42 | PREND | LLESH | KOCAJ | 8593 | 11/319 | 68,5 | 36000 | Konf.nga ZVRPP |
| 43 | FRANO | MARK | KRONI | 8593 | 11/269 | 44 | 2000 | Konf.nga ZVRPP |
| 44 | FATMIR | | TUSHA | 8592 | 8/322 | 79,3 | 22500 | Konf.nga ZVRPP |
| 45 | SKENDER | | KRAJA | 8592 | 8/316 | 29,3 | 33600 | Konf.nga ZVRPP |
| 46 | ISMET | | BALA | 8594 | 8/50 | 22,4 | 4000 | Konf.nga ZVRPP |
| 47 | FAIK | BEQIR | HYKAJ | 8594 | 8/174 | 135,7 | 54500 | Konf.nga ZVRPP |
| 48 | SAMI,KUJTIM,NAIM | | DONIKU | 8594 | 8/214 | 146,6 | 25000 | Konf.nga ZVRPP |
| 49 | ADRIAN | QAMIL | LISAJ | 8594 | 8/215 | 68 | 30000 | Konf.nga ZVRPP |
| 50 | FERIT BARDHI , IMER | | KALLDRICA | 8594 | 8/216 | 80 | 17250 | Konf.nga ZVRPP |
| 51 | GJERGJ&TONIN | | NIKA | 8592 | 8/76 | 137,8 | 6500 | Konf.nga ZVRPP |
| | **TOTALI** | | | | | **6157,1** | **1303800** | |

## VENDIM
## Nr. 374, datë 11.6.2014

## PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË PËRDORIMIT TË FONDEVE KUNDËRPARTI, TË MBLEDHURA NGA GRANTET JAPONEZE PËR SEKTORIN E BUJQËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet kundërparti të dhëna nga qeveria japoneze dhe të mbledhura nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si agjenci e pagesave, në shumën 130 517 500 (njëqind e tridhjetë milionë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë, të trajtohen si të ardhura jashtë limiti dhe të përdoren nëpërmjet llogarisë së thesarit brenda vitit 2014.

2. Këto fonde të përdoren nga AZHBR-ja në formën e huas pa interes, me qëllim nxitjen, rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral dhe përpunimin e këtyre produkteve.

3. AZHBR-ja mund të realizojë disa herë, brenda vitit 2014, procedurën e pranimit dhe të vlerësimit të aplikimeve, deri në përdorimin e plotë të fondeve.

4. Vlerat monetare që do të përdoren për mbështetjen e zhvillimit bujqësor dhe blegtoral të jenë në përpjesëtim me masën e investimit të vetë përfituesit.

5. Fondet kundërparti për vitin 2014 të përdoren për:

a) ndërtim/rikonstruksion të stallave, pularive apo modernizim të komplekseve blegtorale dhe instalim të impianteve të tyre ndihmëse;

b) ndërtim/rikonstruksion (përfshirë edhe serra), blerje dhe instalim të linjave për ruajtje, përpunim dhe ambalazhim të produkteve bujqësore, blegtorale.

6. Masa e financimit për këto investime të jetë në varësi të llojit dhe të vlerës së vetë investimit, përkatësisht:

a) Për ndërtim/rikonstruksion të stallave, pularive apo modernizim të komplekseve blegtorale dhe instalim të impianteve të tyre ndihmëse, deri në 70% të vlerës së përllogaritur të investimit, por jo më shumë se 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë;

b) Për ndërtim/rikonstruksion (përfshirë edhe serrat), blerje dhe instalim të linjave për ruajtje, përpunim dhe ambalazhim të produkteve bujqësore e blegtorale, deri në 80% të vlerës së përllogaritur të investimit, por jo më shumë se 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë.

7. Vlerat monetare të lëvruara për të mbështetur zhvillimin e investimeve të sipërpërmendura në formën e huas pa interes, të jenë me maturim 7 (shtatë)-vjeçar.

8. Procedurat, kriteret e përfitimit të huas, shlyerjes së detyrimeve dhe mënyra e administrimit të fondit të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe të ministrit të Financave.

9. Kriteret e vlerësimit dhe pikëzimit përcaktohen në udhëzimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

10. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 375, datë 11.6.2014

## PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 904, DATË 12.12.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT TË PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE NË ZONAT PILOT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, pikat 1 e 6, 20, pikat 3 e 4, dhe 42 e 42/1, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 904, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas shkronjës "b" të pikës 5, shtohet shkronja "c", me këtë përmbajtje:

"c) Të drejtën për ta tërhequr dhe marrë në dorëzim ndihmën ekonomike e ka bashkëshortja.".

b) Në pikën 9, fjalët "…brenda 10 (dhjetë) ditëve të para të çdo muaji, …" zëvendësohen me " … brenda 20 (njëzet) ditëve të para, në dymujorin e parë, dhe brenda 10 (dhjetë) ditëve të çdo muaji në vazhdim.".

c) Shtojcat 1, pjesët 1 dhe 1b, 2 dhe 3, zëvendësohen me shtojcat sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi që janë pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

APLIKIM PËR "NDIHMËN EKONOMIKE"

Shtojca 1
Përmbledhje e aplikimit
**Nr.**
**Aplikimi:** [APPLICATION_NO]
**Aplikanti** [APPLICANT]

Ju falënderojmë që pranuat të merrni pjesë në këtë proces. Ky është një formular i ri aplikimi dhe intervista e sotme në rastin tuaj merret si përzgjedhje për përfitim të mundshëm. Ky informacion do të jetë konfidencial.

"Ndihma ekonomike" synon të ndihmojë familjet dhe grupe shoqërore në nevojë të cilat nuk mund të sigurojnë nevojat bazë të jetesës, si dhe për të zbutur varfërinë dhe përjashtimin social.

Dokumentet e nevojshme dhe certifikatat përfshijnë:

1) Kopje e kartës së identitetit të aplikantit dhe e anëtarëve të tjerë të familjes që janë posedues të kartës së identitetit;
2) Certifikata e lindjes ose dokumente të tjera të fëmijëve që nuk posedojnë karta identiteti;
3) Certifikata të tjera që lidhen me regjistrin e familjes;
4) Dokumente të tjera të nevojshme për të përcaktuar të ardhurat dhe rrethanat/gjendjen familjare.

Ky formular aplikimi i ka pesë pjesë:

Pjesa 1a -Demografia e familjes;
Pjesa 2 – Banesa;
Pjesa 3 - Pasuritë/asetet shtëpiake;
Pjesa 4 - Mbrojtja sociale;
Pjesa 5 - Të ardhurat.

A jeni i gatshëm të na lejoni të vizitojmë shtëpinë tuaj për pjesën e testit "Vizita në shtëpi"? PO JO

**Aplikanti**

Anëtari i familjes, i cili është përzgjedhur për të përfaqësuar familjen, duhet të jetë në moshë madhore dhe të ketë marrë numrin e identifikimit kombëtar. Numri i identifikimit kombëtar i aplikantit është thelbësore për shqyrtimin e aplikimit.

**Përkufizimi i familjes**

"Familja" është një grup individësh, të lidhur në marrëdhënie bashkëshortore, si dhe në marrëdhënie prind-fëmijë, në marrëdhënie ndërmjet anëtarëve të familjes dhe në marrëdhënie të kujdestarisë mes personash që jetojnë nën të njëjtën çati.

Autorizoj MMSR për të aksesuar të dhënat konfidenciale të aplikantit.

**Emri i administratorit social** [ADMIN_NAME]
**Vendi i intervistës** [PLACE]
**Data e intervistës** [INTERVIEW_DATE]
**Emri dhe firma e aplikantit** ______________________________

| | Data e intervistës | Koha e fillimit | Koha e perfundimit |
|---|---|---|---|
| **Statusi i intervistës** | / / | / | / |

## Pjesa 1: Demografia e familjes

1 *Te dhena personale* Mbiemri [ ] Emri [ ]

2 *Numri i identifikimit kombëtar të aplikantit ashtu siç tregohet në kartën e identitetit* [ ]

3 *Adresa* Kodi-postar [ ] Bashki/komune [ ] Qarku [ ]

*Ju do të merrni informacion me postë, por në disa raste, do të dëshironim të lidheshim me ju me telefon*

Rruga [ ] No. [ ] Block [ ] Apartment [ ]

Rajoni (Bregdetar-1 ; Qendror-2; Malor-3; Tirana-4) [ ] Zona (Urbane-1, Rurale-2) [ ]

Tel shtepise [ ] *I padisponueshem* [ ] Celulari [ ] *I pa disponueshem* [ ]

4 *Gjuha* Në cilën gjuhë do të preferonit të merrnit informacion të mëtejshëm në lidhje me kërkesën tuaj? [shqip]

5 **Grupi etnik** Shqiptar [ ] Grek [ ] Roma [ ] Maqedonas [ ] Malazezë [ ] Vllahe [ ] Te tjera [ ]

6 *Çertifikatë familjare*

| | A | B | C | D | E | F | G | H | J |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | EMRAT E ANËTARËVE TË FAMILJES: BËNI NJË LISTË TË PLOTË TË TË GJITHË PERSONAVE NE FJALE PARA SE SHKONI TEK PYETJET 4-10 | Numri i identifikimit te personit (IDNP) - Tregoni N / A, nëse asnjë | Seksi:<br>M 1<br>F 2 | Data e lindjes (dite/muaj/viti) | Mosha | Marredheniet me kryefamiljarin:<br>Kryefamiljari 1<br>Bashkeshortja/Partneri 2<br>Femija/femija i adoptuar 3<br>Niper 4<br>Mbesa 5<br>Baba/mama 6<br>Moter / vella 7<br>SON/ Dhender/Nuse 8<br>Kurnatë/kurnata 9<br>Gjysh/gjyshe 10<br>Vjehërr/vjehrra 11<br>Të afërm të tjerë 12<br>Jo të afërm 13 | Gjendja civile<br>1. I martuar<br>2. Divorcuar/ndarë<br>3. Jetojne se bashku<br>4. I ve/vejushe<br>5. Beqar | A vuan [EMRI] nga një sëmundje kronike apo paaftësi që ka zgjatur më shumë se 3 muaj (duke përfshirë edhe depresionin e rëndë)?<br>po 1<br>jo 2 | Kryerja e vaksinimin sipas kalendarit te detyrueshëm për grup moshat e fëmijëve.<br>po 1<br>jo 2 |
| 1 | | | | | | | | | |
| 2 | | | | | | | | | |
| 3 | | | | | | | | | |
| 4 | | | | | | | | | |
| 5 | | | | | | | | | |
| 6 | | | | | | | | | |
| 7 | | | | | | | | | |
| 8 | | | | | | | | | |
| 9 | | | | | | | | | |
| 10 | | | | | | | | | |
| 11 | | | | | | | | | |

# Pjesa 1b: Arsimi dhe Punësim

| ID Code | Cili është niveli më i lartë I arsimimit tuaj?<br>Asnjë 0<br>Arsimi fillor 1<br>Perfunduar 8/9 vite arsim fillor 2<br>Arsim I mesëm I pergjithshem 3<br>Arsim Profesional 2-3 vjet 4<br>Arsim profesional 4-5 vjet 5<br>Perfunduar universitetin ne Shqiperi 6<br>Perfunduar universitetin jashte Shqiperise 7<br>Pas universitar ne Shqiperi 8<br>Pas universitar jashte Shqiperise 9 | Ndjekja e arsimit te detyrueshem<br>1= Po<br>2= Jo | PYET TË GJITHË NE FAMILJE 16 VJEC E LARTE<br>A keni punuar në 4 javët e fundit? Përfshirë punën e papaguar në një fermë apo biznes familjar apo edhe disa orë punë si e rastësishme?<br>1= Po<br>2= Jo | PYET TË GJITHË NE FAMILJE 16 VJEC E LARTE<br>Nëse ju nuk keni punuar, a keni pasur një punë nga e cila keni munguar përkohësisht?<br>1= Po<br>2= Jo | Ne kete pune, ju jeni…<br>1 = I punësuar nga punëdhënës që nuk është pjestar i familjes<br>2 = I punësuar me pagesë në një fermë familjare apo biznes<br>3=Punëdhënes<br>4 = I vetë-punësuar<br>5 = I punësuar pa pagesë ne fermë/biznes familjare<br>6=te tjera___ | A keni të drejtë te perfitoni nga skema e sigurimeve shoqërore në këtë punë?<br>1= Po<br>2= Jo | Sa ishte pagesa juaj e fundit apo fitimet NETO? (Nëse i intervistuari ende nuk është paguar, PYETe: Çfarë pagese presin) Cilën periudhë kohore mbulon kjo pagese / apo fitim?<br>Njesia ne kohe<br>Muaj 1<br>15 dite 2<br>Javore 3<br>Ditore 4<br>LEKE | Njesia kohore | Sa është pagesa/fitimi juaj i zakonshem NETO? Çfarë periudhe kohore mbulon kjo pagese? (merr parasysh kohën e 12 muajve të fundit, nëse ju keni filluar punë më pak se 12 muaj më parë, merr në konsideratë mesataren qysh nga fillimi)<br>Njesia kohore<br>Muaj 1<br>15 Dite 2<br>Javore 3<br>Dite 4<br>LEKE | Njesia Kohore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | | | | | | | | |
| 2 | | | | | | | | | | |
| 3 | | | | | | | | | | |
| 4 | | | | | | | | | | |
| 5 | | | | | | | | | | |
| 6 | | | | | | | | | | |
| 7 | | | | | | | | | | |
| 8 | | | | | | | | | | |
| 9 | | | | | | | | | | |
| 10 | | | | | | | | | | |
| 11 | | | | | | | | | | |

Shtojca 2

DEKLARATË E PARAQITJES ÇDO 3 MUAJ

Anëtarët madhorë të familjes kërkuese për ndihmë ekonomike paraqiten nga data 1 deri 15 çdo 3 muaj pranë administratorëve shoqërorë, në bazë të nenit 20 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar.
Aplikanti për ndihmë ekonomike _____________
Adresa e banimit

PËRBËRJA DHE GJENDJA E FAMILJEVE
Muaji

| **Nr.** | **Emri, mbiemri** | **Datëlindja ditë, muaj, vit** | **Lidhja me kryefamiljarin** | **Gjendja aktuale** |
|---|---|---|---|---|
| 1. | | | | |
| 2 | | | | |
| 3. | | | | |
| 4. | | | | |
| 5. | | | | |
| 6. | | | | |
| 7.... | | | | |

Shënim. Te kolona “gjendja aktuale” të shkruhet shënimi përkatës për çdo anëtar të familjes:
i punësuar, i vetëpunësuar, i papunë, pensionist, nxënës, student, fëmijë, ushtar, në spital, jashtë shtetit, në institucione etj.
Keni ndryshim në deklaratën e gjendjes ekonomike dhe sociale të familjes.

Po_______ , Jo______ .

Në rast se Po, shkruani ndryshimet përkatëse.

___________________________________________________________________________

________________________________________________

Emri, mbiemri i bashkëshortes që do të tërheqë, marrë në dorëzim ndihmën ekonomike.

Fëmija ka kryer vaksinën e radhës ____Po _____Jo, sipas kalendarit të përcaktuar, arsyen e moskryerjes _______________________________________________________________

Firmat
Emri, mbiemri,

____________________

Data ____________ u mor në dorëzim nga administratori shoqëror
Firma ___________________
Anëtarë madhorë të familjes.

SIMBOLET PËR VARIABLAT DHE KOEFICIENTËT E PËRDORUR NË FORMULËN E VLERËSIMIT TË KONSUMIT

Shtojcë 3

| | Simbolet: | |
|---|---|---|
| | Variablat | Koeficientet |
| Treguesve të madhësisë së familjes: | | |
| - kryefamiljar; | A | *coef a* |
| - madhësia e familjes; | B | *coef b* |
| - përllogaritja e madhësisë së familjes; | C | *coef c* |
| - pjesa e fëmijëve; | D | *coef d* |
| - frekuentimi i shkollës për arsim të detyrueshëm; | DH | *coef dh* |
| - pjesa e anëtarëve të moshuar; | E | *coef e* |
| - pjesa e anëtareve femra; | F | *coef f* |
| - niveli arsimor i anëtarëve të familjes; | G | *coef g* |
| Kushteve të jetesës: | | |
| nëse banesa e familjes përmban: | H | *coef h* |

| | | |
|---|---|---|
| - tualet brenda; | I | *coef i* |
| - kuzhinë më vete; | J | *coef j* |
| - tarracë/verandë; | K | *coef k* |
| - garazh; | L | *coef l* |
| - depo; | M | *coef m* |
| - ka ujë të rrjedhshëm brenda; | N | *coef n* |
| - përdorin gaz; | O | *coef o* |
| - kanë ngrohje qendrore me gaz apo energji; | P | *coef p* |
| - kanë matës elektrik; | R | *coef r* |
| - dhomat për person; | S | *coef s* |
| - familja zotëron banesën; | T | *coef t* |
| - distanca nga banesa në spital. | U | *coef u* |
| Zotërimit të aseteve: | | |
| - zotërojnë TV me ngjyra; | V | *coef v1* |
| - frigorifer; | $V_2$ | *coef v2* |
| - video/DVD; | V3 | *coef v3* |
| - lavariçe; | V4 | *coef v4* |
| - lavastovilje; | V5 | *coef v5* |
| - sobë elektrike apo me gaz; | V6 | *coef v6* |
| - sobë me dru; | V7 | *coef v7* |
| - kondicioner; | V8 | *coef v8* |
| - bolier; | V9 | *coef v9* |
| - kompjuter personal; | V10 | *coef v10* |
| - satelit; | V11 | *coef v11* |
| - makinë; | V12 | *coef v12* |
| - motor. | V13 | *coef v13* |
| Të ardhura të tjera | | |
| - Remitanca/ dhurata nga të afërm jashtë shtetit; | W1 | *coef w1* |
| - Dhurata nga të afërm në Shqipëri; | W2 | *coef w2* |
| - Dhurata nga të afërm të tjerë (përfshirë dhurata për një ceremoni); | W3 | *coef w3* |
| - Dhurata/ asistencë nga institucione. | W4 | *coef w4* |
| Të ardhura nga qiratë | | |
| Qira nga toka /por jo tokë bujqësore; | W5 | *coef w5* |
| Qira nga apartamentet/shtëpia; | W6 | *coef w6* |
| Qira nga dyqani, dyqanet etj.; | W7 | *coef w7* |
| Qira nga makina, kamioni apo automjete të tjera. | W8 | *coef w8* |
| Të ardhura nga shitjet e aseteve | | |
| - Shitje e pronës së patundshme (shtëpi, tokë...); | W9 | *coef w91* |
| - Shitje e mallrave të qëndrueshme të familjes; | W10 | *coef w10* |
| - Shitje e aseteve të tjera. | W11 | *coef w11* |
| Të ardhura të tjera | | |
| - Nga ndonjë trashëgimi; | W12 | *coef w12* |
| - Fitime nga lotaritë apo bixhozi/kumari; | W13 | *coef w13* |
| - Të ardhura të tjera (_____). | W14 | *Coef w14* |
| Të ardhura bujqësore | | |
| - Prodhime bujqësore të shitura /bimë bujqësore; | W15 | *coef w15* |
| - Produkte të shitura bujqësore si (mjaltë, pije alkoolike (raki, verë), ushqim të përpunuar etj.; | W16 | *coef w16* |
| - Gjë e gjallë e shitur /shtazore | W17 | *coef w17* |
| - Nënprodukte shtazore të shitura (vezë, qumësht, djathë, lesh, lëkurë bagëtish, etj.). | W18 | *coef w18* |
| Të ardhura në lekë në dorë ose kontribut në natyrë nga kooperativat bujqësore apo shoqata të tilla | W19 | *coef w20* |
| Shkalla e varfërisë (harta e varfërisë 2008) | X | *coef x* |
| Konstante | Y | *coef y* |

**VENDIM**
**Nr. 376, datë 11.6.2014**

## PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 787, DATË 14.12.2005, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE TË MASËS SË NDIHMËS EKONOMIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, 19, pika 3, 20, pika 2, 29, pika 10, dhe 35, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 787, datë 14.12.2005, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2, fjalët "… duke deklaruar dhe personin madhor, që do të administrojë paratë …" shfuqizohen.

2. Pas shkronjës "dh" të pikës 2 shtohen shkronjat "e" dhe "ë", me këtë përmbajtje:

"e) Vërtetimin për ndjekjen e shkollës lëshuar nga shkolla, i cili është i detyrueshëm për t'u dorëzuar dy herë brenda një viti shkollor;

ë) Fotokopje të librezës së vaksinimit që provon vaksinimin sipas kalendarit të detyrueshëm për grup - moshat e fëmijëve.".

3. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Për kushte të veçanta social-ekonomike dhe shëndetësore të familjes, administratorët shoqërorë duhet të kërkojnë dokumente shtesë, si: raportin mjekësor, vërtetimin e gjykatës, i cili të dëshmojë që bashkëshortët janë në proces zgjidhjeje martese.".

4. Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"18. Masa e ndihmës ekonomike të plotë mujore nga fondet e buxhetit të shtetit përcaktohet në bazë të strukturës së familjes, si më poshtë vijon:

a) Për bashkëshortët, shuma 3 200 (tre mijë e dyqind) lekë në muaj;

b) Për anëtarët e familjes mbi moshë pune dhe për bashkëshortët e vetëm, shuma 2 600 (dy mijë e gjashtëqind) lekë në muaj;

c) Për çdo anëtar tjetër të familjes, në moshë pune, shuma 600 (gjashtëqind) lekë në muaj;

ç) Për çdo anëtar tjetër të familjes, nën moshë pune (deri 18 vjeç), shuma 700 (shtatëqind) lekë në muaj. Për ata anëtarë të familjes, fëmijë, të cilët vërtetojnë që ndjekin arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar, deri në moshën 16 vjeç, marrin një shtesë në masën prej 300 (treqind) lekësh gjatë vitit shkollor. Për ata anëtarë të familjes, fëmijë, të cilët vërtetojnë që janë vaksinuar sipas kalendarit të vaksinimit, marrin një shtesë në masën prej 100 (njëqind) lekësh, për çdo vaksinë të kryer.".

5. Pas pikës 23/1 shtohet pika 23/2, me këtë përmbajtje:

"23/2. Të drejtën për ta tërhequr dhe marrë në dorëzim ndihmën ekonomike e ka bashkëshortja.".

6. Modulet 1 dhe 2 zëvendësohen me modulet sipas formateve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

Mod. 1

DEKLARATË E GJENDJES EKONOMIKE DHE SOCIALE TË FAMILJES
Viti__________

Kryefamiljari ______________________________
Emri, atësia, mbiemri
Numri i sigurimit shoqëror ______________________ Numri i anëtarëve të familjes
Adresa e banimit ___________________________________________________
Numri i dokumentit të identifikimit ____________________________

TË ARDHURAT QË SIGURON FAMILJA

1. Të ardhura nga veprimtaria ekonomike

(punësimi, vetëpunësimi, pune e paregjistruar, punë pranë një anëtari të vetëpunësuar të familjes, biznesi i vogël privat të tjera…)

(lloji i veprimtarisë ekonomike që kryejnë anëtarët e familjes)

Të ardhurat ___________________ lekë në muaj

2. Të ardhurat nga sistemi i sigurimeve shoqërore

(pension pleqërie, pension invaliditeti, pension familjar, pension e të tjera, pagesë papunësie etj… )

(lloji i pensionit ose pagesa e papunësisë që përfiton personi apo familja)

Të ardhurat ______________ lekë në muaj
3. Të ardhurat nga emigracioni: PO/JO
Të ardhurat ________________ lekë në muaj
4. Të ardhurat nga letrat me vlerë (bono, aksione, obligacione)
Të ardhurat _________________ lekë në muaj
5. Të ardhura nga depozita në bankë (brenda, jashtë vendit): PO/JO
Të ardhurat _________________ lekë në muaj
6. Trashëgimi në vlerë monetare (brenda, jashtë vendit) PO/JO
Të ardhurat _________________ lekë në muaj
7. Të ardhura të tjera
(nga qiratë, shitjet e mjeteve dhe pronave të ndryshme, llogaritë etj.)
(lloji i të ardhurave)
Të ardhurat ______________ lekë në muaj

8. Të ardhurat nga prona, përdorimi i tyre nga pronari apo persona të tjerë
EMËRTIMI PO TË ARDHURAT LEKË NË MUAJ JO
a) Dyqan, lokal tregtimi: shërbimi, prodhim;
b) Bar, restorant, hotel, kioskë;
c) Depo, magazinë, hangar;
d) Parking, garazh, servis lavash;
e) Troje të ndryshme;
f) Automjete (veturë, kamion, autobus, mikrobus, autovinç, zetor, motokarro e të tjera);
g) Mjete të thjeshta transporti dhe kafshë;
h) Të tjera.

9. Të ardhura nga bujqësia
EMËRTIMI Sipërfaqe $m^2$ kategoria të ardhura lekë në muaj
1 Tokë arë,
Nga kjo, sera
2 Pemëtari,
3 Vreshta,
4 Ullishte,
5 Kullotë,
6 Pyll.
GJITHSEJ

10. Të ardhura nga blegtoria
Nr. EMËRTIMI KRERË TË ARDHURA LEKË NË MUAJ
1. Gjedhë (lopë)
2. Të imta (dele/dhi)
3. Dosa
4. Gica
5. Zgjua blete

TË DHËNA TË TJERA SOCIALE
1. STREHIMI
Tipi i banesës: pallat, shtëpi përdhese, barakë, vilë etj.____.
KONTRATA E BANESËS_____________________________________________________
Jeton në: Banesë më vete_______. Banesë e përbashkët _______ Banesë jo të vetëm______
Numri i të ndarëve: 1 1+1 2 + 1 3+ 1
2. ARSIMI , PROFESIONI, PUNA
Nr. Emri, mbiemri, arsimi-viti shkollor (muaji ), profesioni, data e shkëputjes nga puna
3. Gjendja shëndetësore e anëtarëve të familjes dhe kryerja e vaksinimit për fëmijët

______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________

4. Probleme të tjera sociale të familjes

Probleme me të miturit, adoleshentët, të moshuarit, probleme të çiftit, keqtrajtime të anëtarëve të familjes, shfrytëzime, abuzime etj.

______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
__________________________

Emri, mbiemri i bashkëshortes që do të tërheqë/marrë në dorëzim ndihmën ekonomike

________________________________________

Kryefamiljari

Emri, mbiemri, firma

_______________________

Mod. 2

DEKLARATË E PARAQITJES MUJORE TË FAMILJES

Anëtarët madhorë të familjes kërkuese për ndihmë ekonomike paraqiten nga data 1 deri 15 të çdo muaji pranë administratorëve shoqërorë në bazë të nenit 20 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar.

Kryefamiljari _____________

Adresa e banimit

PËRBËRJA DHE GJENDJA E FAMILJEVE

Muaji

Nr. Emri, mbiemri. Datëlindja: ditë, muaj, vit. Lidhja me kryefamiljarin. Gjendja aktuale

1.
2.
3.
4.
5.
6.
7.

Shënim. Te kolona “gjendja aktuale” të shkruhet shënimi përkatës për çdo anëtar të familjes: i punësuar, i vetëpunësuar, i papunë, pensionist, nxënës, student, fëmijë, ushtar, në spital, jashtë shtetit, në institucione etj.

Keni ndryshim në deklaratën e gjendjes ekonomike dhe sociale të familjes.

Po________, Jo_______ .

Në rast se Po, shkruanin ndryshimet përkatëse

______________________________________________________________________________
_________________________________________________________

Emri, mbiemri i bashkëshortes për ta tërhequr/marrë në dorëzim ndihmën ekonomike.

_________________________________.

Fëmijët kanë ndjekur arsimin e detyrueshëm ________Po ______Jo , arsyen e mosfrekuentimit

_______________________________________________________________________.

Fëmija ka kryer vaksinën e radhës ____Po _____Jo, sipas kalendarit të përcaktuar, arsyen e moskryerjes

______________________________________________________________

Ne anëtarë madhorë të familjes (mbi 18 vjeç) plotësojmë këtë deklaratë nën përgjegjësinë tonë personale dhe ligjore. Në rast se do të rezultojnë fakte të kundërta me deklarimet, do të mbajmë përgjegjësi të plotë sipas ligjeve në fuqi.

Anëtarë madhorë të familjes

Emri, mbiemri, firma

## VENDIM
## Nr. 377, datë 11.6.2014

## PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË SHËRBIMIT KOMBËTAR PËR RININË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 6 të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. SHËRBIMI KOMBËTAR PËR RININË

1. Krijimin e Shërbimit Kombëtar për Rininë (në vijim "SHKR"), si person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për politikat dhe çështjet rinore.

2. SHKR-ja ka për mision të garantojë mbështetjen dhe përfshirjen e rinisë në të gjitha fushat e veprimtarisë sociale e publike.

3. Funksionet e SHKR-së janë:

a) zbatimi i politikave dhe programeve të hartuara e të miratuara nga ministria përgjegjëse për politikat dhe çështjet rinore;

b) monitorimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë së qendrave rajonale rinore.

II. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHKR-së

1. SHKR-ja organizohet dhe funksionon në nivel qendror nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të SHKR-së.

2. Qendrat rajonale rinore krijohen si njësi të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve për të rinjtë, në varësi të SHKR-së.

3. Drejtoria e Përgjithshme e SHKR-së ka këto përgjegjësi:

a) zbaton politikat dhe programet për rininë, të hartuara nga ministria përgjegjëse për politikat dhe çështjet rinore;

b) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për hartimin, bashkërendimin dhe zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve për rininë;

c) nxit bashkëpunimin me organizma, institucione, donatorë dhe aktorë të tjerë, ndërkombëtarë apo vendas, për realizimin e veprimtarive që synojnë realizimin e politikave dhe programeve për rininë;

ç) bashkërendon dhe monitoron punën për administrimin e qendrave rajonale rinore;

d) miraton planet e propozuara të aktiviteteve dhe veprimtarive të qendrave rajonale rinore, mbështetur në strategjitë dhe programet e miratuara për rininë;

dh) monitoron respektimin e kritereve ligjore për kryerjen e veprimtarive rinore, të cilat zhvillohen në qendrat rajonale rinore;

e) kontribuon në informimin, konsultimin dhe aksesin e publikut gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave e strategjive në fushën e rinisë;

ë) menaxhon burimet njerëzore, çështjet ligjore, teknologjinë e informacionit, mirëmbajtjen dhe shërbimet e tjera mbështetëse, përfshirë qendrat rajonale rinore;

f) zbaton dhe administron buxhetin, mban kontabilitetin dhe kryen auditin e brendshëm, përfshirë qendrat rajonale rinore.

4. SHKR-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili është titullari i institucionit dhe ushtron këto detyra:

a) përfaqëson SHKR-në në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për organizimin, koordinimin, funksionimin dhe performancën e veprimtarisë së SHKR-së;

b) zbaton dhe administron buxhetin e miratuar të SHKR-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përgatit projektbuxhetin për vitin e ardhshëm, të cilin ia përcjell ministrit përgjegjës;

c) bashkërendon veprimtarinë e SHKR-së me organet qendrore dhe organet e tjera shtetërore që veprojnë e ndërmarrin nisma në fushën e çështjeve rinore;

ç) siguron kontakte me organe homologe dhe organizata të ndryshme, vendase e të huaja, për zgjidhjen efektive të problemeve në fushën e politikave dhe çështjeve rinore, si dhe veprimtari të tjera për plotësimin e detyrave të përcaktuara nga ministria përgjegjëse dhe legjislacioni në fuqi;

d) siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e SHKR-së.

5. Procedura e emërimit, lirimit dhe shkarkimit nga detyra e drejtorit të Përgjithshëm të SHKR-së bëhet sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil".

6. Rregullorja e brendshme organizative e Shërbimit Kombëtar për Rininë miratohet nga ministri përgjegjës për politikat dhe çështjet e rinisë, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm.

7. Drejtori i Përgjithshëm i SHKR-së i raporton drejtpërdrejt ministrit përgjegjës, përveçse kur ministri ka përcaktuar shprehimisht, me urdhër, një njësi tjetër raportimi në aparatin e ministrisë përgjegjëse për politikat dhe çështjet rinore.

8. Qendrat rajonale rinore ushtrojnë veprimtarinë e tyre në rajonin përkatës dhe janë përgjegjëse për:

a) zhvillimin e veprimtarive rinore, kulturore, artistike, letrare e sportive, në zbatim të politikave dhe programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për politikat dhe çështjet rinore;

b) organizimin e takimeve, konferencave, fushatave sensibilizuese e kurseve trajnuese për përfshirjen e rinisë në jetën sociale, punësim e vendimmarrje.

9. Qendrat rajonale rinore drejtohen nga drejtuesi i qendrës, i cili e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e funksionimit, si dhe për cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarive.

10. Drejtuesi i Qendrës Rajonale Rinore është përgjegjës për:

a) drejtimin dhe administrimin e Qendrës Rajonale Rinore;

b) zbatimin e programeve të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e SHKR-së.

11. Drejtuesi i Qendrës Rajonale Rinore i raporton dhe i jep llogari drejtpërdrejt drejtorit të Përgjithshëm të SHKR-së përveçse kur ky i fundit ka përcaktuar shprehimisht, me urdhër, një njësi tjetër raportimi pranë SHKR-së.

III. STEMA DHE VULA ZYRTARE E SHKR-SË

1. SHKR-ja identifikohet me stemën dhe vulën zyrtare.

2. Stema e SHKR-së përbëhet nga stema e Republikës dhe shënimet: "Republika e Shqipërisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Shërbimi Kombëtar për Rininë".

3. Vula e SHKR-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 2 të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulvave zyrtare", të ndryshuar. Vula e SHKR-së në nivel qendror përmban dhe shënimin identifikues "Shërbimi Kombëtar për Rininë", ndërsa vulat e qendrave rajonale rinore përmbajnë dhe shënimin identifikues "Shërbimi Kombëtar për Rininë-Qendra Rajonale Rinore (emri përkatës i qendrës rajonale)".

4. Vula e SHKR-së dhe vulat e qendrave rajonale rinore prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me vendimin nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e prodhimit administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare", dhe në përputhje me vendimin nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj", të ndryshuar.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Ngarkohet ministri përgjegjës për politikat dhe çështjet rinore që, brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të marrë masat për përgatitjen e strukturës e të organikës së SHKR-së dhe të qendrave rajonale rinore, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i shtetit, miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 379, datë 11.6.2014

## PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1, DATË 10.1.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROKURIMIN PUBLIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit së Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në "Rregullat e prokurimit publik", që i bashkëlidhen vendimit nr. 1, datë 10.1.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në pikën 3 të kreut III, "Dokumentet e tenderit", të bëhen këto shtesa:

1. Në nënndarjen"i", "Për kapacitetet financiare dhe ekonomike", të shkronjës"a", "Kontratat e punëve", pas fjalëve "…një deklaratë për gjendjen financiare nga një ose më shumë banka…" shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.".

2. Në nënndarjen"i", "Për kapacitetet financiare dhe ekonomike", të shkronjës"b", "Kontratat e mallrave", pas fjalëve "…një deklaratë për gjendjen financiare nga një ose më shumë banka…" shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.".

3. Në nëndarjen"i", "Për kapacitetet financiare dhe ekonomike", të shkronjës"c", "Kontratat e shërbimeve",

pas fjalëve "…një deklaratë për gjendjen financiare nga një ose më shumë banka…" shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 380, datë 11.6.2014

## PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 942, DATË 17.11.2010,TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE DHE TË DOKUMENTACIONIT PËR MARRJEN E LEJEVE MINERARE NË ZONAT E HAPURA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 29 e 30, pikat 1e 11, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 10 të vendimit nr. 942, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Pas shkronjës"ç" të shkronjës "A.1", shtohet shkronja"ç/1", me këtë përmbajtje:

" ç/1. Në çdo rast, kërkuesi është i detyruar që, përveç një ose disa vërtetimeve që provojnë kapacitetin financiar, të përcaktuara në shkronjën "ç", të paraqesë detyrimisht edhe një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të energjisë elektrike për kontratën/at e energjisë që ka kërkuesi, i regjistruar në Shqipëri. Mosplotësimi i këtij kushti përbën shkak për refuzimin e aplikimit, përveç rasteve kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.".

2. Pas shkronjës"ç" të shkronjës "B.1" shtohet shkronja"ç/1", me këtë përmbajtje:

"ç/1. Në çdo rast, kërkuesi është i detyruar që, përveç një ose disa vërtetimeve që provojnë kapacitetin financiar, të përcaktuara në shkronjën "ç", të paraqesë detyrimisht edhe një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të energjisë elektrike për kontratën/at e energjisë që ka kërkuesi, i regjistruar në Shqipëri. Mosplotësimi i këtij kushti përbën shkak për refuzimin e aplikimit, përveç rasteve kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

## KËRKESË

Shtetasja Nazmije Koka, e bija e Besimit dhe e Eminesë, lindur dhe banuese në Tiranë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të zhdukur të xhxhait të saj, shtetasit Abdyl Mustafa Koka.

KËRKUESJA
**Nazmije Koka**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

| | |
|---|---|
| | Formati: 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 32 lekë

Adresa: bulevardi “Gjergj Fishta”, pas ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006